



RAPORTI VJETOR 2021

20 VITE
BESIM DHE
PARTNERITET

Banka
Ekonomike

The background is a solid red color. It features several large, thin white circular lines that overlap each other, creating a pattern of white arcs and segments. The text is positioned in the upper right area of the page.

**RAPORTI
VJETOR
2021**

PËRMBAJTJA

Mesazhi nga bordi i drejtorëve	6
Mesazhi nga menaxhmenti ekzekutiv	8
Struktura organizative e Bankës	13
Vizioni	14
Misioni	14
Vlerat tona	14
Mjedisi makroekonomik	16
Spektori bankar	17
Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës	19
Pjesëmarrja në kredi	21
Pjesëmarrja në depozita	23
Pasqyra e pozicionit financiar	25
Pasqyra e të ardhurave	27
Performanca e Bankës Ekonomike	30
Asetet e bankës	30
Ecuria e kredive	32
Ecuria e depozitave	33
Shpenzimet operative	35
Zhvillimi i biznesit	38
Portofoli kreditor	39
Klientët korporatë	41
Klientët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	43
Klientët individualë	44
Lizingu	45
Kreditë hipotekare dhe lizingu për patundshmëri	46
Kanalet e distribuimit	48
Rrjeti i degëve	48

Kanalet alternative të shërbimit ndaj klientit - qendra e thirrjeve	50
Menaxhimi i rrezikut	50
Menaxhimi i rrezikut kreditor	52
Rreziku operacional	54
Rreziku i likuiditetit dhe tregut	55
Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit	57
Komiteti për Menaxhim të Rrezikut (KMR)	57
Operacionet dhe pagesat	58
Transferet kombëtare	59
Transferet ndërkombëtare	60
Garancitë dhe letërkreditë ndërkombëtare	61
Kartelat bankare	62
Siguria e informacionit dhe teknologjia informative	63
Menaxhimi dhe trajnimi i personelit	64
Më të rejat nga trajnimet inovative!	67
Pajtueshmëria e përgjithshme	68
Përgjegjësia sociale e korporatës	69
Mbështetja për Asociacionin Nacional të Autizmit në Kosovë	69
Mbjellja e 540 drunjve në 27 komuna të Kosovës	70
Banka në bashkëpunim me klubin Alpin Prishtina surprizojnë fëmijët e shtrirë në Klinikën Pediatrike	70
Mbështetja për sportin	71
Dhurimi i gjakut	72
Mbështetja për gratë	73
Mbështetja për Shoqatën e të Verbërve	73
Udhëtimi i stafit në Stamboll	74
Tetori rozë	74
Mbështetja e aktivitetit kulturor Prite n'shesh	74

MESAZHI NGA BORDI I DREJTORËVE

Të nderuar klientë, punonjës dhe aksionarë të Bankës Ekonomike,

Ndërsa përmbyllim edhe një vit dhe shohim përpara një vit të ri, dua të shpreh falënderimet e mia për besimin tuaj dhe që zgjodhët Bankën Ekonomike si partnerin tuaj financiar.

COVID-19 dhe ndikimet e saj kanë qenë unike dhe të jashtëzakonshme, duke kërkuar nga të gjithë ne të mendojmë dhe të veprojmë në rrethana dhe mënyra të reja. Pavarësisht, gjatë kësaj periudhe Banka Ekonomike ka mbetur e fokusuar për të qenë pranë jush, familjeve tuaja dhe komunitetit tuaj që të ju ndihmojë t'i kaloni sfidat e sotme dhe të lundroni në rimëkëmbjen e së ardhmes. Kjo ishte një përgjegjësi dhe një privilegj të cilin secili nga ne e trajtoi me përgjegjësi dhe ndërgjegjshmëri.

Që nga komunikimi i fundit i rezultateve vjetore, Banka Ekonomike ka vazhduar të rritet falë besimit të klientëve dhe angazhimit të stafit të saj. Viti 2021 ka shënuar vitin më të suksesshëm të Bankës Ekonomike që nga themelimi i saj, duke e etabluar kështu si akter të rëndësishëm në tregun bankar në Kosovë, me rritje të qëndrueshme dhe e cila menaxhohet me kujdes dhe dije, përmbush projeksionet e saja dhe qeveriset mbi baza të shëndosha korporative në një mjedis biznesi konkurrues dhe të mbikëqyrur nga institucioni licencues.

Pavarësisht gjendjes me COVID-19, ne kemi vazhduar të ofrojmë shërbime jetike bankare, duke ju mbajtur ju dhe kolegët tanë të sigurt dhe duke ndjekur të gjitha udhëzimet mbi shëndetin publik.

Mbi të gjitha, të vetëdijshëm se gjendja e pandemisë ka mbartur në vete pasiguri të konsiderueshme ekonomike dhe financiare, ne jemi angazhuar dhe kemi mbështetur klientët tanë me qëllim të lehtësimit dhe dhënies së ndihmës së nevojshme për t'i tejkaluar vështirësitë në shërbim të komunitetit dhe ekonomisë.

Gjatë këtij viti, Banka Ekonomike ka intensifikuar mbështetjen e saj për grupe të caktuara të shoqërisë me synimin për t'i përfshirë këto kategori në jetën sociale dhe publike dhe për të promovuar barazinë gjinore. Përveç kësaj, Banka Ekonomike ka mbështetur aktivitete kulturore dhe klubet sportive në mbarë Kosovën, derisa së bashku me kolegët tanë kemi realizuar mbi 500 orë pune vullnetare për promovimin dhe mbrojtjen e ambientit.

Në anën tjetër, ne kemi vazhduar të investojmë në përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës digjitale dhe asaj fizike për t'ju shërbyer dhe për ta përmirësuar eksperiencën tuaj bankare në një mjedis që transformohet me shpejtësi, duke reflektuar përkushtimin tonë për të qenë një partner i vërtetë i nevojave tuaja financiare. Ngjashëm, Banka Ekonomike ka para vetes një plan ambicioz zhvillimi të markës së saj në mbulimin e një game të gjerë nevojash financiare për klientët e saj në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit për vitet në vijim.

Banka Ekonomike ka rrugëtuar suksesshëm së bashku me ju gjatë 20 viteve që nga themelimi i saj dhe gjendet në një pozicion stabil financiar dhe e angazhuar për t'ju shërbyer gjatë gjitha momenteve të rëndësishme në jetën tuaj personale dhe profesionale.

Në emër të Bordit të Drejtorëve, ju falënderoj personalisht që jeni klient i Bankës Ekonomike, sikurse u shpreh mirënjohje të gjithë punonjësve, menaxhmentit për lidhshëpin e tyre të jashtëzakonshëm dhe aksionarëve për punën, përkushtimin dhe besimin e dhënë.

Në emër të Bordit të Drejtorëve,

Valon Lluka
Kryesues

MESAZHI NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV

Të nderuar klientë,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar bashkëpunëtorë dhe aksionarë të Bankës Ekonomike,

Është kënaqësi e veçantë t'ju drejtohem në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv, për të ndarë me ju vitin më të suksesshëm të Bankës Ekonomike. Viti 2021 shënoi 20-vjetorin e Bankës Ekonomike, i cili nuk është vetëm një përvjetor i korporatës sonë, por është një përvjetor i një familje që rrugëtimin e nisi si banka e vetme me kapital 100 përqind vendor, ashtu siç vazhdojmë të jemi edhe sot.

Pa dyshim, edhe ky vit u dominua nga efektet negative të pandemisë COVID-19. Si rezultat i saj, si të gjitha vendet e rajonit që filluan rikuperimin ekonomik, edhe ekonomia e Kosovës vlerësohet të ketë rikuperuar aktivitetin ekonomik pas gjysmës së parë të vitit 2021. Ky trend pozitiv kryesisht i atribuohet lehtësimit të masave kufizuese si rezultat i përmirësimit të krizës shëndetësore në këtë periudhë.

Përkundër sfidave me pandeminë COVID-19, jemi krenarë që e kaluam vitin që lamë pas me suksese që janë për t'u përshëndetur. Puna ekipore, përkushtimi dhe profesionalizmi i punonjësve tanë dëshmuar se janë më të fuqishëm se çfarëdo sfide e jashtme, duke bërë që institucioni ynë të arrijë këtu ku jemi sot.

Përgjatë vitit 2021, afirmuam pozicionin tonë si banka me rritjen më të madhe në treg në kredi dhe depozita, ku shënuam rritje të dyfishtë në krahasim me industrinë; prej 32.26 përqind në kredi (total tregu 15.33 përqind rritje) dhe rritje prej 24.02 përqind në depozita (total tregu 12.41 përqind rritje), që është një tregues i mbështetjes së vazhdueshme të zhvillimit ekonomik të vendit, gjithnjë duke ruajtur një pozicion të shëndetshëm të likuiditetit, duke qenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe duke punuar në vazhdimësi në përmirësim të proceseve.

Banka Ekonomike, si asnjëherë më parë, arriti që gjatë vitit 2021 të gjenerojë 7.9 milionë euro fitim para tatimit, shifër kjo më e larta në 20 vite që nga themelimi i Bankës. Portofoli i kredive vazhdoi të rritet në mënyrë të kujdesshme me një rritje prej 82.9 milionë euro (↑32.30 përqind),

ndërsa portofoli jonë vazhdon të jetë cilësor me një nivel të kredive joperformuese në vetëm 2.73 përqind. Një tregues i besueshmërisë 20-vjeçare që klientët e kanë ndërtuar me Bankën Ekonomike është edhe rritja e portofolit të depozitave, të cilat arritën nivelin më të lartë ndonjëherë, në 412 milionë euro.

Për më shumë, Banka Ekonomike, për të qenë në hap me zhvillimet e fundit në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe bashkëkohore, prioritet ka ofrimin e shërbimeve me vëmendje në avancim dhe personalizim të vazhdueshëm. E gjithë kjo përmes modernizimit të infrastrukturës së rrjetit të degëve, me qëllim që të jetë sa më afër klientëve dhe në të njëjtën kohë t'u ofrojë shërbime përmes teknologjive moderne duke nxitur zhvillim edhe më të madh ekonomik të vendit. Nga ana tjetër, për të zgjeruar prezencën tek klientët, kemi hapur nëndegë të re në Prizen dhe kemi rialokuar nëndegët tona në qytetet e Rahovecit dhe Kamenicës në pozicione më atraktive. Rrjedhimisht, me 29 degë dhe nëndegë në të gjithë vendin, dëshmojmë edhe njëherë qëllimin për të qenë sa më pranë klientëve.

Për 20 vite, Banka Ekonomike ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetareve, vlerësim të cilin na bëjnë çdo ditë klientët tanë, konfirmon edhe një herë misionin e Bankës për të ofruar shërbime moderne dhe kualitative për të gjithë klientët tanë. Kështu, Banka u nderua me çmimin prestigjioz ndërkombëtar për “decade of Excellence in Banking Kosovo 2021” nga revista prestigjioze “Global Banking and Finance”, e cila është ndër publikuesit kryesorë në shqyrtimin e performancës të sektorit bankar.

Përvjetorë si ky, përveç që na bëjnë krenarë, në të njëjtën kohë na motivojnë që fuqishëm të angazhohemi për një të ardhme edhe më të suksesshme. Forcimi i mëtejshëm i pozicionit të Bankës Ekonomike në sektorin bankar është një nga objektivat kryesore. Ne këtë drejtim, ne do të vazhdojmë që të investojmë në resurse humane, si në trajnimin e punonjësve dhe modernizimin teknologjik në vazhdimësi si pjesë e zotimit tonë që të tejkalojmë vazhdimisht pritshmërinë e klientëve tanë dhe të rrisim efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve.

Duke qenë banka e vetme me kapital 100 përqind vendor, gjatë rrugëtimit tonë 20-vjeçar kemi qenë shumë të përkushtuar edhe në aspektin e përgjegjësisë sociale, kështu, gjatë vitit 2021 kemi mbështetur më shumë se 30 projekte në vend, që janë në linjë me objektivat e Bankës për një zhvillim të qëndrueshëm, siç janë mbështetja e 15 aktiviteteve sportive, si: alpinizëm, basketboll, futboll, volejbol, hendboll dhe golf. Po ashtu, një kontribut tjetër i veçantë i është dhënë mjedisit, me theks të veçantë në kontributin për një ambient më të pastër dhe një klimë më të shëndetshme përmes mbjelljes së 540 drunjve në 27 komuna të Kosovës. Njëkohësisht, kemi kontribuar në mbështetjen e kulturës, shëndetësisë, edukimit, kategorive të marginalizuara dhe iniciativave të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin dhe mirëqenien shoqërore.

Në fund, në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv, një falënderim i veçantë u drejtohet klientëve dhe aksionareve tanë për mbështetjen dhe besimin e dhënë, Bordit të Drejtorëve për përkrahjen e vazhdueshme, e pa dyshim dhe punonjësve tanë për vullnetin dhe përkushtimin e treguar në punë.

Në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv

Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv



Shpend Luzha

Kryeshef Ekzekutiv



Hamide Pacolli Gashi

Zv. Kryeshefe Ekzekutive



Arijan Haxhibeqiri


Zv. Kryeshef Ekzekutiv



Banka Ekonomike

Banka
Ekonomike

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit




2020

2021

↑ 0.53%

Asetet (në mijëra EUR)




2020

2021

↑ 25.28%

Kreditë (në mijëra EUR)




2020

2021

↑ 32.26%

Depozitat (në mijëra EUR)




2020

2021

↑ 24.02%

Kreditë joperformuese (KJP)




2020

2021

↑ 0.27%

Fitimi para tatimit (në mijëra EUR)




2020

2021

↑ 79.30%

STRUKTURA ORGANIZATIVE E BANKËS



VIZIONI

- Të jemi një nga ofruesit më të mirë dhe më të mëdhenj të shërbimeve financiare në Kosovë.

MISIONI

- Të jemi partneri më i mirë financiar i klientëve tanë, për të arritur rritje dhe qëndrueshmëri ekonomike.
- Të jemi në qendër të kërkesave dhe shërbimeve financiare të klientëve individualë, bizneseve, korporatave dhe klientëve institucionalë.
- T'i mbështesim dhe të rreshtohemi në të gjitha aktivitetet që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.
- Qëllimi ynë parësor është të fitojmë dhe të ruajmë besimin e publikut, si dhe t'u përmbahemi standardeve më të larta etike.

VLERATONA

- Në pikëpamjen afatgjate, ne investojmë në njerëz, produkte dhe teknologji.
- Ne vazhdimisht përpiqemi të përmirësojmë performancën tonë deri në përpikëri.



Monedhë autentike Ilire, me portretin e mbretit Genc

MJEDISI MAKROEKONOMIK

Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, si rezultat i përmirësimit të situatës pandemike, lehtësimit të masave kufizuese si dhe politikës mbështetëse fiskale dhe monetare. Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 10.5 përqind në vitin 2021. Kjo rritje e lartë e aktivitetit ekonomik kryesisht iu atribuua përmirësimit të krizës shëndetësore – dinamikë që u reflektua në lehtësim të masave kufizuese dhe rritje të të hyrave nga jashtë (kryesisht diasporës), dhe politikave stimuluese financiare dhe fiskale. Rritja ekonomike humbi momentumin në TM4 2021, kryesisht si pasojë e variantit të ri të koronavirusit “Omicron” dhe rikthimit të masave në vende të ndryshme, si dhe rritjes së çmimit të energjisë dhe problemeve evidente në zinxhir të furnizimit. Vetëm në TM4 2021, rritja reale e BPV-së rezultoi të ketë qenë 6.4 përqind, mbështetur nga rritja e kërkesës vendore, ndërkohë që eksportet neto kishin kontribut negativ në aktivitetin e gjeneruar ekonomik.

Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rikuperimit ekonomik, shoqëruar me presionet e jashtme inflacioniste si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë dhe çmimeve të mallrave të importuara nga vendet partnere, u përkthye në rritje të çmimeve të përgjithshme edhe në Kosovë. Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje prej 3.4 përqind në vitin 2021, ndërsa rritja më e lartë e çmimeve të konsumit është evidentuar në TM4 2021 kur është shënuar normë mesatare e inflacionit prej 6.4 përqind.

Vetëm në TM4 2021, të hyrat buxhetore shënuan rritje prej 12.9 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej vetëm 0.7 përqind. Borxhi publik ka vazhduar me rritje dyshifrore prej 13.1 përqind dhe ka arritur vlerën 1.68 miliardë euro, përderisa si përqindje e BPV-së ka arritur në 23.3 përqind në TM4 2021.

Rritja e kërkesës së brendshme rezultoi në rritje të importeve, gjë që përkeqësoi balancin e mallrave, përkundër rritjes që shënuan eksportet. Vetëm në TM4 2021, deficitit tregtar i mallrave është rritur për 34.4 përqind dhe ka arritur nivelin prej 1.0 miliardë euro, ndërsa bilanci i shërbimeve arriti vlerën prej 139.2 milionë euro, nga 95.2 milionë euro në TM4 2020.

Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë

SEKTORI BANKAR

Sektori bankar gjatë vitit 2021 u karakterizua me nivel optimal të kapitalizimit, likuiditetit si dhe cilësi të lartë të portofolit kreditor, me gjithë krizën evidente pandemike (COVID-19).

Asetet e sektorit bankar janë karakterizuar me rritje vjetore dyshifrore në tri vitet e fundit, financiar kryesisht përmes depozitave të arkëtuara. Në dhjetor 2021, gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën në 5.96 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.1

përqind. Struktura e aseteve vazhdon të mbetet e ngjashme me vitet paraprake, me kreditë që kanë peshën më të madhe në kuadër të aseteve (62.9 përqind), pasuar nga paratë e gatshme (14.1 përqind), letrat me vlerë (11.5 përqind), dhe mjetet e mbajtura në bankat tjera komerciale (11.1 përqind) e që kryesisht janë jashtë vendit.

Për më tepër, sektori bankar arriti të realizojë fitim në vlerë rekorde dhe u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues dhe rritje dyshifrore të depozitave.

Aktiviteti kredidhënës shënoi rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin e kaluar, duke vazhduar trendin e rritjes dyshifrore të para pandemisë (COVID-19). Në dhjetor 2021, gjithsej kreditë arritën në 3.75 miliardë euro, një rritje vjetore 15.5 përqind (7.1 përqind në periudhën paraprake). Në këtë rritje kontribuuan si sektori i ekonomive familjare, që shënoi rritjen më të lartë, ashtu edhe sektori i korporatave jofinanciare, që njëherësh kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive.

Vlera e depozitave të mbajtura nga sektori bankar në fund të vitit 2021 arriti në 4.90 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.4 përqind. Depozitat e arkëtuara prej ekonomive familjare vazhdojnë të kenë kontributin kryesor në rritje të gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare. Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë rreth 68.7 përqind të gjithsej depozitave, shënuan rritje vjetore prej 14.6 përqind (12.9 përqind në vitin 2020), kryesisht si rezultat i fluksit më të lartë të ardhjes së diasporës - remitancave të pranuar në kanale formale dhe joformale, si dhe i probabilitetit më të lartë të kursimit në kohë pasigurie kundrejt shpenzimit.

Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë



Monedhë epirote të kohës së mbretit Pirro - 306 para erës së re

POZICIONIMI I BANKËS EKONOMIKE NË TREGUN BANKAR TË KOSOVËS

Në vitin 2021, Banka jonë ka arritur të rrisë pozicionin e saj në treg, duke shënuar rritje mbi atë të trendit të tregut bankar, i cili vazhdon të shënojë rritje. Rritja e tregut bankar në të gjitha asetet prej 11.22 përqind është ndikuar edhe nga Banka jonë, e cila ka shënuar rritje në të gjitha asetet prej 25.28 përqind, përkatësisht 14 përqind më shumë se rritja e tregut.

Në numra realë, në fund të vitit 2021, pasuritë/asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike u rritën në 460 milionë euro, krahasuar me 367.9 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2020.

FIGURA 1. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të aseteve të tregut, 31 dhjetor 2021;





FIGURA 2. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të total aseteve të tregut, 31 dhjetor 2021;



PJESËMARRJA NË KREDI

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total kreditë në treg, më 31 dhjetor 2021, qëndronte në 9.11 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar.

Gjatë vitit 2021, Banka jonë ka shënuar një rritje prej 32.3 përqind në kredi, në krahasim me tregun që ka shënuar një rritje prej 15.33 përqind.

FIGURA 3. Rritja e Bankës Ekonomike në kreditë e përgjithshme në raport me tregun, 31 dhjetor 2021;





FIGURA 4. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e kredive në raport me tregun, 31 dhjetor 2021;



PJESËMARRJA NË DEPOZITA

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total depozitat në treg, me 31 dhjetor 2021, ka qenë 8.59 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë.

Gjatë vitit 2021, Banka jonë ka shënuar një rritje prej 24.0 përqind në depozita, në krahasim me tregun që ka shënuar një rritje prej 12.41 përqind.

FIGURA 5. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në depozita në raport me tregun, 31 dhjetor 2021;





FIGURA 6. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e depozitave në raport me tregun, 31 dhjetor 2021;

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Euro '000		
	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe në banka	29,081	24,860
Balanca me Bankën Qendrore të Kosovës	78,542	57,530
Kreditë për klientët	329,296	247,123
Investime në letra me vlerë	5,000	25,365
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	13,796	8,768
Pasuri të paprekshme	3,949	2,813
Pasuri të tjera	1,120	1,423
Gjithsej pasuritë	460,784	367,882
Detyrimet		
Detyrime ndaj klientëve	411,106	330,281
Detyrime ndaj bankave	1,086	2,080
Detyrimi tatimor	253	6

Detyrime të tjera	2,542	2,183
Detyrimi i shtyer tatimor	608	-
Gjithsej detyrimet	415,595	334,550
Ekuiteti dhe rezervat		
Kapitali aksionar	29,422	29,422
Rezerva e rivlerësimit	4,794	63
Fitime të mbajtura	10,973	3,847
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat	45,189	33,332
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat	460,784	367,882

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre me 11 Prill 2022:



Z. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv



Z. Fitim Rexhepaj
Zyrtar Kryesor për Financa

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVETË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

	Euro '000	
	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	21,512	17,965
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	(2,838)	(2,714)
Të ardhurat neto nga interesi	18,674	15,251
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	3,660	2,748
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	(1,300)	(825)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione	2,360	1,923
Të ardhurat e tjera operative	1,907	1,117
Humbja/fitimi neto nga këmbimi valutor	(101)	49
Të ardhurat	22,840	18,340
Shpenzimet e personelit	(3,890)	(3,466)
Zhvlerësimi i pasurive, pajisjeve dhe ROU	(1,994)	(1,975)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	(373)	(302)
Shpenzime të tjera	(6,427)	(4,985)
Humbjet neto nga zhvlerësimi për kreditë	(2,273)	(3,133)
Gjithsej shpenzimet operative	(14,957)	(13,861)

Fitimi para tatimit	7,883	4,479
Tatimi në fitim	(805)	(470)
Fitimi neto për vitin	7,078	4,009
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		
Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje		
Përfitimi në rivlerësimin e tokës dhe ndërtesës, neto nga tatimi	4,725	-
Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje		
Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	54	(309)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	11,857	3,700



*Monedhë autentike Ilire
Vjetërsia: mbi 2000 vjet*

PERFORMANCA E BANKËS EKONOMIKE

Duke vazhduar traditën e rritjes dhe ruajtjes së kënaqshmërisë së klientëve, si dhe duke punuar vazhdimisht për arritjen e caqeve të performancës financiare, Banka jonë, edhe në vitin 2021, ka shënuar progres në shumicën e treguesve financiarë, duke e mbyllur vitin me fitim para tatimit në vlerë prej 7.9 milionë euro.


Të hyrat neto nga interesi kanë shënuar rritje, e kjo rritje në krahasim me vitin e kaluar është 19.7 përqind më e lartë, njëherazi Banka arriti të rekrutojë klientë të rinj në masë të konsiderueshme falë shërbimeve të mira dhe teknologjisë moderne, gjë që vërehet edhe nga rritja prej 26.4 përqind e të hyrave nga komisionet.

Banka jonë mbetet e përkushtuar që t'i realizojë planet e saj afatgjate strategjike, në mënyrë që të vazhdojë t'i kryejë operacionet me sukses gjithmonë në ngritje.

ASETET E BANKËS

Përkushtimi ndaj vlerave, caqeve të performancës dhe angazhimi i vazhdueshëm drejt zgjerimit të rrjetit dhe infrastrukturës së Bankës kanë rezultuar në rritje të aseteve të Bankës për të pestin vit me radhë. Këtë vit, rol të rëndësishëm në rezultatin e rritjes së aseteve ka pasur edhe rritja e portofolit kreditor. Banka jonë ka mbyllur vitin 2021 me 461 milionë euro, për dallim nga viti 2020 kur kishte 368 milionë euro asete.

FIGURA 7: Asetet e Bankës Ekonomike, 2017-2021




Të gjitha shifrat janë në '000 Euro.

ECURIA E KREDIVE

Menaxhimi i duhur i portofolit dhe menaxhimi i balancuar i rrezikut kanë ndikuar që edhe këtë vit të vazhdojë trendi i rritjes. Si rezultat, Banka jonë ka pasur një rritje substanciale në portofolin e kredive, përfshirë sektorin privat dhe atë të biznesit. Gjatë vitit 2021, portofoli i kredive është rritur nga 257 milionë euro në 340 milionë euro.

Banka Ekonomike ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme produktet e saj më të mira të kredidhënies me fushata marketingu.

FIGURA 8: Portofoli i kredive, 2017-2021;




Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

ECURIA E DEPOZITAVE

Rritja e vazhdueshme e depozitave është një tregues më shumë për rritjen e vazhdueshme të besimit të klientëve ndaj shërbimeve të Bankës Ekonomike. Viti 2021 ka shënuar rritje të depozitave në 412 milionë euro, nga 330 milionë euro sa ishte në vitin paraprak.


FIGURA 9: Depozitat e klientëve, 2017-2021:



Të gjitha shifrat janë në '000 Euro.

	Euro '000	2017	2018	2019	2020	2021
Të hyrat nga interesi		13,835	14,500	15,851	17,966	21,513
Kostot e depozitave		2,192	2,316	2,371	2,640	2,783
Të hyrat NETO nga interesi		11,643	12,184	13,480	15,326	18,730
Të hyrat NETO nga komisionet dhe tarifat		1,876	1,931	2,162	2,030	2,467

FIGURA 10: Të hyrat nga interesi, 2017-2021;




Të gjitha shifrat janë në '000 Euro.

SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet operative					
Euro '000	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzimet administrative	4,730	4,406	3,767	4,463	5,083
Shpenzimet e personelit	3,109	3,198	3,274	3,466	3,888
Shpenzimet e zhvlerësimit	834	863	1,827	2,277	2,367
Gjithsej shpenzimet operative	8,673	8,467	8,868	10,206	11,338


FIGURA 11. Shpenzimet operative



Të gjitha shifrat janë në '000 Euro!

Gjatë vitit 2021, Banka Ekonomike u ka kushtuar rëndësi të veçantë investimeve në degë dhe infrastrukturë, por në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin dhe trajnimin e personelit, gjë që ka rezultuar në rritje të shpenzimeve operative të përgjithshme të Bankës dhe rritje të shpenzimeve të zhvlerësimit të aseteve, në krahasim me vitin paraparak. Banka jonë, ndër të tjera, rëndësi të veçantë u ka kushtuar donacioneve për grupet e shoqërisë të cilat kanë qenë më të afektuarat nga pandemia, në mënyrë që sadopak të ua lehtësojë tejkalimin e vështirësive të krijuara nga efektet e pandemisë.

Megjithatë, rishikimi i shpenzimeve operative ka qenë prioritet edhe këtë vit, dhe ka përfshirë rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit, gjithmonë duke qenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat dhe për t'i plotësuar kërkesat dhe nevojat e klientëve tanë.



Helmeta Ilire - 222 para erës së re

ZHVILLIMI I BIZNESIT

Një kujdes të shtuar Banka ka vazhduar t'ia kushtojë zhvillimit dhe zgjerimit të vazhdueshëm dhe të mirëfilltë të departamenteve të cilat janë përgjegjëse për avancimin e biznesit. Në këtë drejtim, vëmendje të shtuar i kemi kushtuar përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të klientëve institucionale, kërkesa këto të cilat u trajtuan në kuadër të Departamentit të Korporatës. Vlen të theksohet se nga ky grup i klientëve kemi pasur rritje të konsiderueshme të depozitave gjatë 12 muajve të vitit 2021, si rrjedhojë e bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm.

Përgjatë vitit 2021 kemi ndërvepruar edhe më afër me klientët korporatë, duke mos u ofruar tashmë vetëm shërbime klasike financiare, por një gamë të gjerë shërbimesh e produktesh, sipas kërkesave dhe specifikave që u nevojiten si dhe duke trajtuar të gjitha kërkesat e tyre brenda afateve sa më të shkurta kohore, gjë që ndikoi edhe në rritjen e volumit dhe frekuencës së transfereve. Të gjitha këto fakte kanë ndikuar pozitivisht në rritje të shëndoshë të portofolit të këtyre klientëve në kuadër të Bankës Ekonomike, e që rrjedhimisht rezultoi të jetë rritja më e madhe (+29.5 milionë euro apo +31.54 përqind) që nga themelimi i departamentit. Për më tepër, duke parë rëndësinë e këtij segmenti të klientëve, Banka do të vazhdojë të zhvillojë dhe përshtatë produktet dhe shërbimet e saj në përkrahje të këtyre bizneseve.

Edhe përgjatë vitit 2021, Banka Ekonomike ka dëshmuar përkushtimin ndaj klientit dhe rritjes së shëndoshë të portofolit të depozitave dhe kredive. Në segmentin e klientëve individuale, duke ofruar shërbime cilësore, ne kemi arritur plotësimin e kërkesave të klientëve për financim në përputhje me të hyrat e tyre, pa dëmtuar kështu buxhetin e tyre dhe pa cenuar mirëqenien e tyre familjare. Kemi arritur të tërheqim klientë edhe përmes modernizimit të proceseve, kështu lansimi i platformës së re ebanking është përgjigje ndaj nevojave, kërkesave dhe feedback-ut të klientëve.

Qasja e lartë profesionale, planet e qarta të biznesit dhe përkushtimi për arritjen e rezultateve kanë ndikuar që ndër vite të jemi stabil, të besueshëm dhe çdoherë pranë klientëve tanë!

Në mënyrë që të jemi më afër klientit dhe më fleksibil në ofertim të kushteve për kredi hipotekare, përgjatë vitit 2021, Banka Ekonomike, në kuadër të zhvillimit të biznesit, ka krijuar njësinë e veçantë e cila ka përgjegjësi rritjen e portofolit kreditor për kredi hipotekare. Duke marrë për bazë kërkesën e klientëve dhe kushtet e tregut në lidhje me patundshmëri, synimi ynë është që klientëve t'u ofrojmë një gamë më të gjerë të produkteve dhe t'i përmbushim kërkesat e tyre duke ofruar edhe produktin e ri "Lizing për Patundshmëri".

Në aspektin e bizneseve të vogla dhe të mesme, në një ambient jostabil të krijuar nga pandemia, Banka jonë demonstroi besim në kapacitetet e bizneseve dhe mirëmbajtje kreditimit të tyre. Krahas kësaj, u vazhdua me iniciativat e segmentimit të filluara në vitin 2020, ku gjatë periudhës 2020-2021 u profilizua Departamenti Agro, duke rritur kështu resurset e specializuara në sektorin Agro. Në të bërit biznes, u intensifikua

shfrytëzimi i fondit garantues si instrument për rritje të qasjes në kapital për bizneset dhe me këtë edhe tejkalimi i kufizimeve për klientët të cilët kishin vështirësi për sigurimin e kolateralit. Të gjitha këto zhvillime, të kombinuara me fushatat specifike, kontribuuan të kemi rritje të ekspozimit kreditor për 21.2 milionë euro, apo +34 përqind, gjithmonë duke mirëmbajtur normat e kredive joperformuese si para pandemisë. Departamenti i Lizingut është parë që ka potencial dhe mundësi zgjerimi të gamës së produkteve bankare dhe të plotësimit të kërkesave të klientëve të Bankës. Produkti i lizingut ka bërë që, përveç plotësimit të këtyre kërkesave, të sjellë edhe klientë të rinj në Bankë, duke bërë që viti 2021 të jetë viti më i suksesshëm deri më tani, ku numri i kontratave aktive të produktit ishte 909 dhe portofoli i mbetur në fund të këtij viti ishte 18 milionë euro.

Këtë vit janë zhvilluar dhe lansuar 18 fushata për produkte, shërbime, fuqizim të brendit si banka e vetme me kapital 100 përqind vendor. E ndër të tjera, në vazhden e modernizimit teknologjik u zbatua strategjia e re e digjitalizimit, e tërë kjo për të qenë në hap me kohën dhe për të gjeneruar një prezencë maksimale në botën digjitale dhe për të tërhequr sa më shumë ndjekës në rrjetet sociale.

PORTOFOLI KREDITOR

Si rezultat i strategjisë së Bankës, gjatë vitit 2021, Banka jonë arriti të ketë një performancë të lartë në të gjitha segmentet e biznesit. Rritja e portofolit kreditor ishte e shpërndarë tek të gjitha segmentet e biznesit, ku kemi edhe rritjen më të madhe të portofolit nga 257 milionë sa ishte në vitin 2020, në 340 milionë në vitin 2021.

Segmenti	Ekspozimi kreditor 2020 në '000	Përqindja e participimit në 2020	Ekspozimi kreditor 2021 në '000	Përqindja e participimit në 2021
NVM	62,560	24.33%	89,801	26.41%
Lizing	7,858	3.06%	17,982	5.29%
Korporatë	93,609	36.41%	122,624	36.06%
Individë	93,098	36.21%	109,673	32.25%
Totali	257,125	100.00%	340,080	100.00%



*Monedhë autentike Ilire
Vjetërsia: mbi 2000 vjet*

KLIENTËT KORPORATË

Edhe gjatë vitit 2021, Banka ka vazhduar të jetë një partner i besueshëm për klientët e të gjitha segmenteve, pavarësisht sfidave me pandeminë dhe masave të kohëpaskohshme të përcaktuara nga institucionet përkatëse.

Për më tepër, nisur nga fakti se gjatë vitit paraprak është bërë centralizimi i trajtimit të klientëve institucionalë (ndërmarrjet publike, OJQ-të, institucionet financiare, kompanitë e sigurimeve, etj.), në kuadër të Departamentit të Korporatës, ndikimi i këtij centralizmi është përkthyer në rezultate të prekshme, nga i cili grup i klientëve kemi pasur rritje të theksuar të depozitave përgjatë vitit 2021.

Biznesi në kuadër të Departamentit të Korporatës përgjatë vitit 2021 ka regjistruar një rritje të konsiderueshme në portofolin kreditor, duke rritur kreditë neto me 29.5 milionë euro ose 31.54 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2021, cilësia e aseteve që rezultojnë në kredi joperformuese përbën vetëm 3.36 përqind të portofolit të kredive, gjë e cila është arritur me monitorim të afërt të portofolit kreditor, e posaçërisht duke ruajtur cilësinë e kredive.



*Monedhë autentike Ilire
Vjetërsia: mbi 2000 vjet*

KLIENTËT E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Viti 2021 në aspektin e biznesit ishte një vit sa i vështirë, po aq edhe storie suksesi.

Sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është sektori me shtrirjen më të madhe dhe më me ndikim në ekonominë e çdo vendi, rrjedhimisht edhe për Banka Ekonomike mbetet një prej sektorëve më të rëndësishëm në kuadër të zhvillimit të biznesit dhe si i tillë ka mbetur në fokus të Bankës. Përkushtimi ynë për të avancuar marrëdhënien, raportin dhe proceset me këtë sektor rezultoi që vitin 2021 ta mbyllim me një rritje të konsiderueshme në aspektin performancës, duke realizuar një rritje të portofolit kreditor në shumë prej 21.2 milionë euro në total, apo +34 përqind, duke shënuar një rritje signifikante të segmentit të kredive për NVM, Mikro dhe Agro.

Duke parë nevojat dhe kërkesat e tregut, si dhe potencialin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Banka Ekonomike në vazhdimësi është përpjekur që t'u përgjigjet këtyre kërkesave në mënyrën më adekuate. Profilizimi i produkteve, në veçanti i produktit të agrokredive, ka kontribuar në ofrimin e mundësisë që ky produkt të avancojë edhe më shumë në të ardhmen. Produkti i agrokredisë, si produkt i veçantë, ka ndikuar në profilizimin e stafit i cili do t'u përgjigjet më së miri kërkesave specifike që mund të ketë ky produkt. Aktualisht, stafi jonë i specializuar për agrokredi mbulon të gjitha regjionet, duke qenë sa më afër klientit.

Referuar kualitetit të portofolit, respektivisht nivelit të kredive joperformuese, segmenti i klientëve NVM mbetet një segment performues me nivelin e pranueshëm institucional të kredive joperformuese.

Në vazhdimësi, fokusi jonë ishte në ofrimin e shërbimeve cilësore e adekuate për klientët tanë, duke venë në plan të parë kërkesat e klientit dhe duke dëshmuar profesionalizëm dhe përgjegjshmëri në shërbimet që ofrojmë. Sikurse në vitin 2021, fokusi ynë mbetet i njëjtë edhe në vijim, duke synuar vazhdimësi të një afarizmi të suksesshëm.

KLIENTËT INDIVIDUALË

Klientët individualë vazhdojnë të mbeten kategoria më me fokus në aspekt të plotësimi të nevojave të tyre përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe produkteve konkurruese të harmonizuara sipas kërkesave të klientëve.

Viti 2021 është përmbyllur me progres shumë të kënaqshëm në aspekt të arritjes dhe realizimit të objektivave të vendosura paraprakisht.

Segmenti i individëve po vazhdon të rritet e të zgjerohet dhe në vazhdimësi ruan me rigorozitet filozofinë e Bankës për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe fleksibile për klientët tanë, duke ofruar kohë pas kohe në treg oferta të ndryshme përmes kampanjave për kredi individuale dhe depozita, të cilat në fokus kanë klientët dhe preferencat e tyre në aspekt të përmbushjes së nevojave për kosum, renovime të shtëpive/banesave si dhe investime afatshkurtra e afatgjata, të cilat kontribuuan në rritjen e portofolit kreditor, depozitave dhe bazës së klientëve.

Të gjitha përpjekjet dhe angazhimet përgjatë vitit të kaluar, përkundër sfidave që solli pandemia në nivel global dhe gjithsesi edhe lokal në të bërit biznes, janë përkthyer në suksese të jashtëzakonshme, ku kemi rritjen në kredi në segmentin e individëve në vlerë prej 12.2 milionë, apo në pikë përqindje prej 13.1 përqind, si dhe total depozitat e klientëve kanë shënuar një rritje prej rreth 57.1 milionë euro, apo 17.2 përqind. Rritja e bazës së klientëve individualë në Bankën Ekonomike ka shënuar rritje substanciale, ku vetëm gjatë vitit 2021 janë hapur mbi 19,500 llogari të reja.

Ky angazhim që u përkthye në rritje, përveç që përmbush objektivat tona strategjike, po ashtu dëshmon sigurinë dhe besimin e klientëve në Bankën Ekonomike, e cila në thelb pasqyron traditë, partneritet dhe siguri.

Në kuadër të rritjes së nivelit të kënaqshmërisë së klientëve, përkundër masave shtrënguese të vendosura në aspekt të kufizimit të numrit të stafit për shkak të pandemisë, ne kemi vijuar me ofrimin dhe fuqizimin e shërbimit cilësor ndaj klientëve nga stafi i shitjes i vendosur në të gjitha degët në Kosovë, gjë që është mirëpritur nga klientët dhe të njëjtën kohë është cilësuar si vlerë e shtuar.

LIZINGU

Edhe gjatë vitit 2021 kemi vazhduar me konsolidimin e mëtejshëm të shërbimit të lizingut, vlen të ceket që Departamenti i Lizingut ka filluar me financimin e stokut si produkt të ri, produkt i cili ofrohet për partnerët e Bankës siç janë autosallonet me të cilat Banka Ekonomike vazhdon financimin e nevojave të klientëve përmes lizingut.

Si departament i ri, vëmendje të veçantë i kemi kushtuar zgjerimit të resurseve tona, përfshirë atyre njerëzore dhe infrastrukturore, ku përmes financimit të klientëve tanë kemi ndikuar edhe në rritjen e aktivitetit ekonomik.

Të gjitha përpjekjet përgjatë vitit u dëshmuar si të duhura dhe të suksesshme, duke dhënë rezultate pozitive të vitit 2021. Përmes lizingut, Banka ka arritur të rrisë bazën e klientëve të rinj, dhe portofolin kreditor në kuadër të lizingut, ndërsa numri i kontratave aktive gjatë vitit 2021 ka arritur në 909, dhe total portofoli aktiv në 18 milionë euro.

Duke e parë si produkt me potencial të madh dhe me rritjen e kërkesës për këtë produkt, në vijim, Banka do vazhdojë edhe më tej me fuqizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve me qëllim të përmbushjes së kërkesave të klientëve për gamën e produkteve që ofron Departamenti i Lizingut.

KREDITË HIPOTEKARE DHE LIZINGU PËR PATUNDSHMËRI

Më qëllim të zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve bankare për klientët tanë, departamenteve të zhvillimit të biznesit u është shtuar edhe Njësia për Kredi Hipotekare dhe Lizing të Patundshmërisë. Kjo njësi u krijua si nevojë për të qenë në hap me tregun e patundshmërive, për shkak të nevojës së Bankës për një rritje të portofolit dhe diversifikim të tij, dhe për të qenë më pranë klientëve duke mbështetur nevojat e tyre me mundësi financimi për objektet rezidenciale.

Si njësi e re e Bankës, vëmendje të veçantë u kemi kushtuar kërkesave të tregut, ku bashkëpunimi i mirëfilltë me investitorët e mirënjohur të industrisë ndërtimore (partnerët afaristë) është një nga qëllimet kryesore të kësaj njësie. Përgjatë periudhës së dytë të vitit të kaluar, arritëm të thellojmë bashkëpunimet me investitorët e lagjeve rezidenciale, ku falë punës sonë të përbashkët kemi arritur të rrisim portofolin nga 16.7 në 23.3 milionë euro dhe kemi arritur të zgjerojmë bashkëpunimin me 8 lagje rezidenciale.

Në vitin 2021, në kuadër të planifikimeve strategjike, kjo njësi, pas një hulumtimi të detajuar të tregut dhe pas shqyrtimit të kërkesave të klientëve, ka përgatitur edhe produktin “Lizing për Patundshmëri”, i cili do lansohet gjatë vitit 2022.



*Monedhë autentike Ilire
Vjetërsia: mbi 2000 vjet*

KANALET E DISTRIBUIMIT


RRJETI I DEGËVE

Teknologjia dhe digjitalizimi i operacioneve biznesore janë kërkesë e kohës, që të gjithë po mundohen ta ndjekin, por edhe afërsia me klientin nuk duhet lënë anash, sepse makineria asnjëherë nuk do të mund ta zëvendësojë kontaktin human. Andaj, me synimin për të qenë gjithmonë më afër klientëve, Banka Ekonomike ka gjithsej 29 degë, të cilat janë të ndara në 7 degë kryesore dhe në 22 nëndegë. Sipas statistikave nga raporti i përgjithshëm i bankave, Banka Ekonomike renditet e 3-ta sipas prezencës në tregun bankar të Kosovës. Kjo dëshmon edhe njëherë që qëllimi i Bankës Ekonomike është të jetë e pranishme në çdo kënd të vendit.

Për të qenë në hap me zhvillimet e fundit në ofrimin e shërbimeve më cilësore në tregun bankar në vend, Banka Ekonomike i ka kushtuar rëndësi të veçantë rrjetit të degëve të Bankës. Gjatë vitit 2021 janë rinovuar degët në pajtueshmëri me standardin e ri me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të shpejta dhe të lehta për klientët. Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit të degëve dhe hapësirave vetëshërbyese, kemi rialokuar në Kamenicë, në Rahovec, dhe është bërë hapja e nëndegës së re në Prizren, të cilat ofrojnë një ambient më modern në industrinë bankare për shërbim të klientëve.

FIGURA 12. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar.

Numri i degëve në tregun bankar



Sa i përket pjesëmarrjes në tregun bankar, për nga numri i bankomateve, marrim pjesë me 11 përqind të tregut. Duke u nisur nga zhvillimi i teknologjisë dhe jeta dinamike, një ndër prioritetet kryesore për Bankën Ekonomike ka qenë fokusimi në ofrimin e shërbimeve në çdo kohë përmes bankomateve.

Në vitin 2021, deponimi i mjeteve në bankomate ka qenë më i lartë në krahasim me vitin paraprak. Viti 2020 ka një rritje prej 77.58 përqind në numër të deponimeve në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2021, në përgjithësi të gjitha llojet e transaksioneve me kartela (deponim, tërheqje dhe blerje) në bankomate kanë pasur rritje si në numër ashtu edhe në vlerë. Në vitin 2021, numri i tërheqjeve është rritur për 24.78 përqind në krahasim me vitin paraprak.

Për të kompletuar ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët, Banka jonë ka një ekip të përkushtuar në çdo degë që siguron që çdo shërbim të ofrohet në mënyrë të duhur dhe çdo kërkesë e klientëve të adresohet me kujdes.

KANALET ALTERNATIVE TË SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT - QENDRA E THIRRJEVE

Qendra e Thirrjeve, si kanal alternativ i shërbimit ndaj klientit, luan një rol të veçantë dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe efikas në adresimin e kërkesave dhe nevojave të klientëve dhe njëkohësisht informimin e tyre në kohë dhe me efektshmëri të lartë. Në këtë qendër, përveç shërbimeve telefonike shfrytëzohen edhe kanale të tjera shtesë si p.sh. emaili, që sikurse edhe thirrjet telefonike, shfrytëzohet që, në raste specifike, t'i trajtojë kërkesat dhe nevojat e klientëve në mënyrë sa më praktike dhe efikase të mundshme.

Funksioni i Qendrës së Thirrjeve luan rol të rëndësishëm në rritjen e ofrimit të shërbimeve dhe plotësimin e kërkesave të klientëve, i cili është në dispozicion 24/7.

Përmes Qendrës së Thirrjeve, Banka jonë ka pranuar 52,503 kërkesa nga klientët si dhe ka ofruar sqarime dhe udhëzime këshilluese rreth produkteve dhe ofertave të Bankës.

Banka jonë do të vazhdojë me fuqizimin dhe ngritjen cilësore të këtij shërbimi.

Fokus i vitit 2021 ishte ofrimi i shërbimeve profesionale dhe rritja e besueshmërisë së klientëve duke zhvilluar marrëdhënie afatgjata me klientët.

MENAXHIMI I RREZIKUT

Viti 2021 është përcjellë me sfida të shkaktuara si pasojë e COVID-19, me ndikim edhe në operacionet e Bankës, duke prekur në veçanti disa industri më të ndjeshme ndaj masave kufizuese. Falë reagimit të shpejtë të të gjithë akterëve përmes politikave fiskale, kreditimit të lartë nga institucionet financiare dhe të hyrave rekorde nga diaspora, dëmi i ekonomisë ishte dukshëm më i vogël sesa pritej në fillim të COVID-19.

Përderisa fushatat e vaksinimit e kishin efektin e vet pozitiv dhe kufizimet filluan të hiqen gradualisht, ekonomia u ringjall fuqishëm gjatë pjesës së dytë të vitit 2021 dhe ekonomia praktikisht u kthye në nivelet e para COVID-19 duke shënuar rritje reale vjetore prej 7.5 përqind¹.

Megjithatë, për shkak të rritjes së kërkesës agregate, ekonomia lokale dhe globale është ballafaquar me probleme logjistike dhe zinxhirë të tensionuar të furnizimit, gjë që ka shkaktuar pengesa në furnizim të energjisë dhe rritje të çmimeve të mallrave bazë duke kaluar të gjitha pritshmëritë fillestare. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni vjetor në Kosovë për vitin 2021 ka arritur nivelin e 6 përqind, fakt që ka ndikuar në uljen e fuqisë blerëse edhe ashtu të kufizuar në nivel të ekonomive familjare. Në anën tjetër, mungesa e fuqisë punëtore e cila po shfaqet në disa sektorë është një tjetër faktor i rëndësishëm që po e kufizon zhvillimin ekonomik në potencialin e plotë të saj.

Procesi i menaxhimit të rrezikut përfshin menaxhimin e rrezikut kreditor, operacional, të tregut, likuiditetit, investimeve apo rreziqeve të tjera të cilave Banka mund t'u ekspozohet në çdo kohë. Më qëllim të arritjes së synimeve strategjike janë hartuar dokumente vjetore - strategji dhe politika për çdo rrezik specifik në mënyrë që të mirëmbahen treguesit kyç të rrezikut, të kontrollohen dhe monitorohen në baza të rregullta, gjithnjë duke pasur për bazë kapitalin e disponueshëm të Bankës. Performanca dhe stabiliteti financiar i Bankës është stabil, bazuar në treguesit kryesor të rreziqeve:

Gjithsej kapitali në raport me mjetet e rrezikuara	13.56%
Niveli i kredive joperformuese	2.75%
Mirëmbajtje e raportit në mes ekspozimeve kreditore me depozita	82.5%
Rezervat për humbjet nga kreditë në raport me kreditë joperformuese	120%

Po ashtu, gjatë këtij viti është avancuar edhe më tutje adaptimi me infrastrukturën rregullative dhe ligjore duke u përshtatur të gjitha kërkesat që rrjedhin qoftë nga kërkesat e rregullatorit apo nga standardet ndërkombëtare. Kalkulimi i humbjeve (provizioneve) është avancuar në përputhje me standardet e reja ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) duke integruar faktorët makroekonomikë në parashikimin e humbjeve të pritura nga kreditë.

¹ <https://www.imf.org/en/News/Articles/2022/01/11/pr2204-imf-executive-board-concludes-2021-article-iv-consultation-with-the-republic-of-kosovo>

MENAXHIMI I RREZIKUT KREDITOR

Banka Ekonomike, sikurse edhe institucionet tjera financiare, është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor, që është ndër rreziqet më materiale dhe me ndikim më të lartë në performancën e përgjithshme të Bankës. Fokus kryesor i Bankës ka qenë rritja e cilësisë së kreditimit duke ndikuar në përmirësimin e të gjithë treguesve cilësorë të portofolit kreditor. Për të siguruar vazhdimësi në afarizëm si proces të rregullt, Banka e bën identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut kreditor dhe ka krijuar mekanizma për menaxhimin dhe monitorimin e rrezikut kreditor. Banka po ashtu ka parasysh koncentrimin e rrezikut kreditor, duke marrë për bazë diversifikimin e portofolit kreditor nëpër industri dhe profile të ndryshme, që mund të vijë si pasojë e ndryshimeve makroekonomike apo faktorëve të jashtëm. Si rezultat i politikave kreditore të aprovuara nga Banka, limiti maksimal i kredisë për një klient apo grup të ndërlidhur të klientëve gjithnjë mbahet nën limitet e rregullatorit, duke zvogëluar kështu rrezikun e koncentrimin të kredisë.

Për këtë qëllim, Banka ka vazhduar të mbajë trendin e njëjtë në diversifikimin e portofolit kreditor të ndërmarrjeve të segmentit biznes dhe klientëve individualë duke alokuar një pjesë të portofolit kreditor në ekonomitë familjare, po ashtu ka përkrahur rritjen e segmentit të lizingut financiar duke ofruar mbështetje edhe të produkteve të reja lizing (financimin e mallit), mbështetje e theksuar në financimin e projekteve i është dhënë edhe ndërmarrjeve biznese. Banka ka shfrytëzuar mundësinë e transferimit të rrezikut kreditor tek palët e treta, duke shfrytëzuar edhe këtë vit mundësinë e financimit nëpërmjet Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ku përmes dritareve garantuese të Fondit, Banka ka ofruar kampanja kreditore në segmentin e biznesit me kushtet lehtësuese të ky segment, gjë që ka ndikuar në zbutjen e rrezikut kreditor.

Banka po ashtu ka filluar me implementimin e rejtingut të brendshëm kreditor duke integruar këtë model edhe në politikat kreditore që po ashtu shfrytëzohet për nevoja të provizionimit kreditor në kuadër të SICR. Ky model ka të integruar faktorë kuantitativë financiarë dhe ata kualitativë dhe në fund kalkulohet rejtingu i brendshëm kreditor dhe kategorizohet profili i rrezikut.

Niveli i kredive joperformuese është tregues shumë i rëndësishëm duke shprehur raportin e kredive joperformuese ndaj total ekspozimeve kreditore. Menaxhimi i kredive joperformuese në fundvit pësoi një rritje të vogël, nga 2.46 përqind (dhjetor 2020) në 2.75 përqind (dhjetor 2021). Ky trend ishte i qëndrueshëm si një rritje e moderuar, kur merren parasysh efektet e shaktuara nga pandemia që ka pasur ndikim më të lartë te disa sektorë. Vlen të theksohet se Banka ka monitoruar me kujdes të veçantë ekspozimet kreditore të ristrukturara sipas udhëzimit të BQK-së për COVID-19.

Menaxhimi i rrezikut kreditor bëhet përmes vlerësimit të vazhdueshëm të aftësisë kreditore të huamarrësve ndërsa ekspozimet kreditore >50,000 euro monitorohen së paku në baza vjetore. Departamenti për Rrezikun Kreditor ka për qëllim të menaxhojë cilësinë e portofolit kreditor në përputhje me rregulloret e BQK-së, si dhe politikat dhe procedurat e aprovuara nga Banka.



*Monedhë autentike Ilire
Vjetërsia: mbi 2000 vjet*

RREZIKU OPERACIONAL

Rreziku operacional përkufizohet ndryshe edhe si rreziku i humbjeve të shkaktuara nga proceset e brendshme joadekuate apo të dështuara, të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme. Banka ka një sistem të zhvilluar të rrezikut operacional që i përshtatet natyrës së Bankës sa i përket identifikimit të treguesve kyç të rrezikut dhe kontrollit të incidenteve të rrezikut operacional në mënyrë të vazhdueshme, me të vetmin qëllim të zvogëlojë ndikimin financiar dhe frekuencën e një incidenti.

Banka vazhdon të mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme operationale, si pasojë e avancimeve teknologjike në fushën e shërbimeve financiare të cilat, ndër të tjera, e kanë bërë këtë rrezik më të ndjeshëm të shkaktuar nga proceset e brendshme dhe ngjarjet e jashtme.

Për të krijuar një kontroll më efektiv mbi rrezikun operacional, Banka ka zbatuar procesin e vetëvlerësimit në kuadër të proceseve më kritike dhe Banka vlerëson se mbajnë rrezik operacional. Po ashtu, Banka vlerëson profilin ekzistues të rrezikut nëpërmjet kategorizimit të incidenteve në bazën e të dhënave, duke përfshirë ngjarjet që çojnë drejt rrezikut potencial operacional. Për më tepër, Banka ka instaluar standarde të larta të monitorimit të rrezikut operacional kundrejt raportimeve dhe ofron trajnime të vazhdueshme të rrezikut operacional për gjithë punonjësit, e në veçanti për ata që janë përgjegjës për raportimin e incidenteve të rrezikut operacional dhe për punëtorët e rinj. Përmes qasjeve të standardizuara në menaxhim të rrezikut operacional kemi arritur përmirësim të dukshëm në cilësinë e të dhënave si pikë kyçe në vendimmarrje në raport me incidentet e paraqitura në komitetet e rrezikut operacional.

Andaj, me gjithë rritjen e vazhdueshme të ekspozimit ndaj rrezikut operacional, menaxhimi i këtij rreziku ishte adekuat, duke izoluar pasojat e tij si rezultat i aktiviteteve të ndara sipas Bazelit. Banka ka arritur të ndërmarrë hapa kundrejt një kontrole sa më efektive mbi menaxhimin e rrezikut operacional, duke zbatuar plotësisht vetëvlerësimin e profilin ekzistues të rrezikut të Bankës.

RREZIKU I LIKUIDITETIT DHE TREGUT

Rreziku i likuiditetit shfaqet kur nuk ka mjete të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat e financimit në kohën e duhur dhe po ashtu mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen në kohë me çmime të përshtatshme. Në anën tjetër, si pjesë e rrezikut të tregut shfaqet kur një pasuri e Bankës mund të humbasë në vlerë për shkak të ndryshimit të normës së interesit.

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit dhe afarizmit vazhdon të përfaqësohet nga depozitat të cilat shënuan rritje, kryesisht nga personat juridikë në raport me depozitat e personave fizikë. Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet 'mbi 1 vit'. Depozitat me afat maturimit 'deri në 1 vit' dominuan strukturën e depozitave të afatizuara. Për të njëjtin qëllim është ndërtuar modeli i stresimit të depozitave për qëndrueshmëri afatgjatë në Bankë. Raportet në mes depozitave dhe ekspozimeve kreditore vazhdojnë të kenë shpërputhje dhe rritje të rrezikut sidomos të pjesa e interesit për ekspozime kreditore afatgjatë, prandaj është zbatuar produkti i normës variable të interesit me qëllim të menaxhimit të hendekut dhe konkurrencës sa u përket lëvizjeve të normave të interesit.

Rezervat e likuiditetit vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 34.91 përqind, në raport me kërkesën ligjore prej 25 përqind. Banka është likuide sepse ka aftësi t'i përmbushë në kohë detyrimet aktuale dhe të ardhshme. Gjatë gjithë periudhës janë mirëmbajtur limitet e përcaktuara nga rregullatori, si dhe në baza të rregullta janë monitoruar indikatorët kyç të likuiditetit të cilët japin sinjale pozitive për stabilitet në Bankë. Në anën tjetër, si pjesë e Bazel III, Banka kalkulon në baza të rregullta raportin e mbulueshmërisë së likuiditetit duke siguruar që Banka është duke e mbajtur këtë raport >100 përqind.



*Monedhë autentike Ilire
Vjetërsia: mbi 2000 vjet*

PROCESI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Banka ka zbatuar dokumentin i cili si koncept ka për qëllim t'i identifikojë, vlerësojë dhe menaxhojë të gjitha rreziqet sipas shtyllës së dytë të standardeve të Bazelit për mjaftueshmërinë e kapitalit. Ky proces i standardizuar i vlerësimit të brendshëm është i rëndësishëm për planifikimin e kërkesave minimale për kapital, ndaj të cilave Banka është e ekspozuar apo mund të ekspozohet në mënyrë që të vazhdojë me operacione të rregullta të biznesit. Rreziqet individuale që rrjedhin prej modelit apo strategjisë gjatë kohëzgjatjes së planit të biznesit, koncentrimi i portofolit kreditor, kolaterali, rreziku operacional, i likuiditetit, i normës së interesit, përcakton nevojën e planifikimit të kapitalit për këto rreziqe.

KOMITETI PËR MENAXHIM TË RREZIKUT (KMR)

Në baza të rregullta, të gjitha aktivitetet e ndërmarra për menaxhim të rrezikut në nivel Banke diskutohen dhe raportohen në KMR në nivel Bordi të Drejtorëve. KMR është organ më i lartë sa i përket mbikëqyrjes së Bankës për aktivitetet e rrezikut. Të gjitha politikat për menaxhim të çdo rreziku specifik, limitet, indikatorët e rrezikut analizohen, vlerësohen dhe paraprakisht validohen nga KMR dhe në fund rekomandohen për aprovim në Bord të Drejtorëve të Bankës.

OPERACIONET DHE PAGESAT

Edhe pse viti 2021 ka vazhduar të jetë vit i sfidave që ka sjellë pandemia COVID-19, Banka Ekonomike ka vazhduar përqendrimin në shërbimin e klientëve dhe stabilitetin e funksioneve operationale duke zhvilluar dhe zbatuar një numër të projekteve zhvillimore që kanë të bëjnë me përmirësimin e proceseve të Bankës dhe plotësimin e kërkesave ligjore vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Me këtë, Banka Ekonomike vazhdon të jetë konkurrent në treg, duke qenë e orientuar drejt përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës së shërbimeve ndaj klientëve të vet.

SWIFT GPI - një standard të ri i zbatuar për transferet ndërkombëtare përmes SWIFT-it, me ç'rast Bankës Ekonomike i mundësohet menaxhimi i plotë dhe i shpejtë i transfereve hyrëse dhe dalëse të klientëve të saj që nga inicimi deri tek pranimi i pagesës.

Banka Ekonomike vazhdon me procesin e personalizimit të kartelave të klientëve brenda Kosovës për kategorinë e pensionistëve. Gjithashtu, kemi investuar në rritjen e efikasitetit të prodhimit të kartelës nga aplikimi deri tek dorëzimi i kartelës tek klienti.


Banka Ekonomike ka zbatuar projekte të ndryshme që kontribuojnë në rritjen e sigurisë së transfereve ndërkombëtare.

Me qëllim të ofrimeve të shërbimeve më cilësore dhe atraktive për klientët e Bankës Ekonomike, në pjesën e dytë të vitit 2021, në bashkëpunim me **PostFinance AG** nga Zvicra, kemi mundësuar përmes shërbimit **Corridor Service** dërgimin e remitancave nga çdo bankë zvicerane me **0 përqind komision**, ku në bazë të këtij bashkëpunimi Banka Ekonomike ka vendosur gjithashtu që për pagesat hyrëse të pranuar për klientët e saj përmes shërbimit Corridor Service po ashtu të mos aplikojë komision. Me anë të këtij shërbimi, klientëve tanë iu është mundësuar pranimi i pagesave në valutën CHF më shpejt si dhe me një kosto dukshëm të reduktuar.

TRANSFERET KOMBËTARE

Vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse është rritur, nga 1.07 miliardë sa ishte në vitin 2020, në 1.54 miliardë në vitin 2021, që përbën një rritje prej rreth 44 përqind, përderisa gjatë vitit 2021 transferet dalëse kombëtare të kryera në sportel kanë pësuar një rritje prej 41 përqind krahasuar me vitin paraprak. Në kuadër të strategjisë së Bankës sonë për avancim të mëtejme të automatizimit të proceseve dhe shfrytëzimit të kanaleve alternative, shfrytëzueshmëria e platformës E-Banking është rritur për 38 përqind në numër dhe 78 përqind në vlerë.

FIGURA 13. Transferet kombëtare, hyrëse dhe dalëse;




Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

TRANSFERET NDËRKOMBËTARE

Transferet ndërkombëtare në vitin 2021 kanë pasur rritje krahasuar me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse është rritur rreth 21 përqind, nga 317 mijë sa ishte në vitin 2020, në 383 mijë për vitin 2021, siç është prezantuar në tabelën më poshtë. Shfrytëzueshmëria e platformës E-Banking sa i përket pagesave ndërkombëtare është rritur për 49 përqind në numër dhe 57 përqind në vlerë.

FIGURA 14. Transferet ndërkombëtare, hyrëse dhe dalëse;




Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

GARANCIONET DHE LETËRKREDITË NDËRKOMBËTARE

Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare në vitin 2021, krahasuar me vitin paraparak, kanë pasur rritje. Nëse marrim shumën totale të garancioneve në këtë vit kemi rritje rreth 15 përqind në krahasim me vitin e kaluar.

FIGURA 15. Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare ndër vite.




Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

KARTELAT BANKARE

Banka Ekonomike u ofron klientëve kartela debiti dhe krediti për kryerjen e shërbimeve brenda dhe jashtë vendit në bashkëpunim me partnerët Master Card dhe Visa, si në bankomate, POS terminale dhe po ashtu në pagesa online. Gjithashtu, me kartelat debitore lokale, kategorisë së pensionistëve u mundësohet procesi i tërheqjeve të mjeteve në bankomatet e Bankës Ekonomike. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i kartelave të debitit ka arritur në 75 mijë dhe ka shënuar rritje për 3 përqind, apo për 2,168 kartela debiti më shumë sesa në vitin paraprak, ndërsa numri i kartelave të kreditit ka arritur në 7,452, apo një rritje për 8.6 përqind apo për 589 kartela krediti më shumë.

FIGURA 16. Numri i kartelave të debitit dhe kreditit ndër vite.



SIGURIA E INFORMACIONIT DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Në linjë me strategjinë e Bankës, departamenti i teknologjisë të informacionit ka vazhduar të mbajë në fokus përmirësimin dhe modernizimin e ekosistemit teknologjik më qëllim të zgjerimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve tona bankare. Si rrjedhojë, edhe këtë vit Banka ka bërë investime të mëdha në infrastrukturën teknologjike, si: (1) ndërtimi i dhomës të re të serverëve sipas standardeve ndërkombëtare, dhe (2) ndërlidhjen e dy qendrave procesuese me lidhje fibër të errët (Ang. dark fiber) e cila mundëson ngritjen e performancës të sistemeve dhe rritë dukshëm qëndrueshmërinë operacionale për nga aspekti teknik.

Krahas investimeve në infrastrukturën teknologjike, në të njëjtën kohë grupi punues për implementimin e sistemit themelor të ri bankar ka vazhduar punët intensive me qëllim të arritjes të objektivave për implementimit e sistemit themelor të ri bankar sipas strategjisë dhe afateve kohore të përcaktuara. Sistemi themelor i ri bankar do të mundësojë optimizimin dhe automatizimin e proceseve aktuale, duke krijuar ekosistem të favorshëm për krijimin e produkteve dhe shërbimeve inovative digjitale bankare për ta bërë përvojën e klientit më superiore dhe më të lehtë.

Viti 2021 gjithashtu ka shënuar rritje rekorde të sulmeve kibernetike që po ndodhin gjithandej nëpër botë dhe në këtë aspekt, Banka ka vazhduar të mbetet e përkushtuar për ofrimin e një mjedisi të sigurt të TI-së duke investuar vazhdimisht në teknologji moderne për detektimin dhe parandalimin të sulmeve kibernetike. Krahas investimit të vazhdueshëm në teknologji moderne të sigurisë kibernetike, Banka vazhdon të investoj në trajnimin dhe afatësimin e burimeve njerëzore në departamentin për sigurinë e Informacionit për të mbetur në trend me zhvillimet e fundit në sektorin e sigurisë kibernetike. Banka mbetet e përkushtuar për të ofruar shërbime dhe produkte inovative dhe të sigurt për nga aspekti i sigurisë të informacionit dhe mbrojtës të të dhënave.

MENAXHIMI DHE TRAJNIMI I PERSONELIT

Edhe pse sfida me pandeminë ka vazhduar edhe këtë vit, fokusi i Bankës sonë ka qenë shëndeti i punonjësve duke zbatuar rregullat e nevojshme si dhe vaksinimin e plotë të tyre.

Mbi 95 përqind e stafit të Bankës tanimë janë vaksinuar duke siguruar kthimin në normalitet dhe zhvillimin e aktiviteteve dhe shërbimit të klientëve në veçanti.

Departamenti i Burimeve Njerëzore vlerëson kontributin e çmueshëm të personelit të saj, përpjekjet e vazhdueshme dhe përkushtimin për rritjen dhe progresin e vazhdueshëm të Bankës gjatë 20 viteve të pranisë së saj në treg.

Një prej elementeve kryesore që e përcolli këtë strategji ishte komunikimi i pandalshëm dhe i vazhdueshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore me secilin punonjës për t'i kuptuar sfidat dhe për të ndihmuar e mbështetur këtë komunikim mes të departamenteve/degëve përkatëse.

Departamenti i Burimeve Njerëzore është faktor i rëndësishëm, i cili gjithashtu kontribuon në zhvillimin dhe realizimin e qëllimeve të përgjithshme të biznesit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Roli i Departamentit të Burimeve Njerëzore është përqendruar në rekrutimin e punëtorëve kompetentë për t'i plotësuar pozitat specifike në Bankë, ku si rezultat i është dhënë mundësia një numri të punëtorëve të brendshëm në nivel të degëve dhe departamenteve që të avancohen në pozita të reja, duke u bazuar në aftësitë dhe shkathtësitë e tyre.

Banka Ekonomike gjithashtu ofron mundësi edhe të kryerjes së punës praktike. Qëllimi i programit të angazhimit të praktikantëve është që t'ua ofrojë studentëve mundësinë e përfitimit të përvojës praktike në sistemin bankar, si dhe t'ua japë mundësinë studentëve dhe të sapodiplomuarve t'i provojnë aftësitë e tyre dhe përvojën akademike në sistemin bankar.

Po ashtu, gjatë vitit 2021 është bërë shpërndarja e mirënjohjeve për punëtorët me mbi 10 vjet përvojë pune në Bankën Ekonomike, me ç'gjë konfirmohet edhe një herë se Banka Ekonomike vazhdon të jetë punëdhënësi i dëshiruar i cili ofron kushte, kulturë të punës dhe ambient të mirë përbrenda.

Për institucionin tonë është shumë e rëndësishme që të gjithë punonjësit tanë të kenë mundësi të zhvillohen në aspektin personal dhe profesional, dhe që punonjësit të kenë mundësi t'i zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre për të performuar më mirë në mjedise pune të cilat sa vijnë e bëhen më sfiduese.

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, edhe këtë vit Departamenti i Burimeve Njerëzore është angazhuar në mënyrë të veçantë në trajnimin dhe zhvillimin e pasurisë më të vlefshme, që janë punëtorët. Vetëm punëtorët profesionalë dhe të trajnuar mirë mund të ofrojnë shërbime të shkëlqyera për klientët, e që kjo rezulton me një ecuri mjaft të mirë të institucionit.

Gjatë vitit 2021, angazhimi më i madh i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka qenë në trajnimin e stafit për lëmenjtë më të rëndësishëm të sistemit bankar, e sidomos për shitjen dhe mënyrën e qasjes ndaj klientit.

Punëtorët e Bankës Ekonomike kanë marrë pjesë në trajnime edhe jashtë vendit, gjë e cila tregon rëndësinë që Banka Ekonomike i kushton integritit të stafit dhe zhvillimit të tyre profesional në tregun bankar.

Departamenti i Burimeve Njerëzore zhvilloi me sukses trajnimet hyrëse për të gjithë punëtorët e rinj.

Pjesa dërmuese e stafit të departamenteve/degëve me grupe të synuara sipas profileve të caktuara janë aftësuar për:

- Pajtueshmëri të përgjithshme
- Pajtueshmëri PPP/F
- E-banking
- Analizë financiare
- Trajnim të shitjes
- Shitje efektive
- Trajnim për segmentin Agro
- Çështje operacionale
- Investimet në 'Bonot e Diasporës'
- Train the Trainers
- Menaxhimi i vetvetes dhe udhëheqja e ekipeve
- Motivimi dhe komunikimi efektiv



Helmeta Ilire - shek 6-5 para erës së re

MË TË REJAT NGA TRAJNIMET INOVATIVE!

Viti 2021 shënon shtimin e një fryme të re të trajnimeve të nivelit më të avancuar dhe të certifikuar nga institucione edukative më kredibile botërore, si: Harvard, Oxford, Cambridge, MIT.

Duke marrë parasysh shkallën e lartë të nevojës për ndryshime në fushën e digjitalizimit të proceseve bankare, gjatë vitit 2021 janë organizuar trajnime të nivelit të avancuar për udhëheqësit e departamenteve.

Përmes këtyre trajnimeve me kredibilitet të lartë ndërkombëtar, e të certifikuar nga Harvard, Oxford, MIT, do të kemi mundësi të mësojmë dhe marrim praktikat më të mira në fushat relevante dhe të identifikuar si të nevojshme, si dhe t'i aplikojnë ato si nivel strategjik.

Trajnimet janë zhvilluar në fusha të ndryshme, si:

- Marketingu digjital
- Shfrytëzimi i së ardhmes digjitale
- Përgatitja për përparësitë e shërbimeve financiare në të ardhmen
- Financa të qëndrueshme Fintech
- Dizajnimi i proceseve digjitale

PAJTUESHMËRIA E PËRGJITHSHME

Departamenti i Pajtuëshmërisë së Përgjithshme në vazhdimësi ka përcjellë kërkesat rregullative dhe të legjislacionit, për të cilat është përkujdesur që të njëjtat të zbatohen brenda Bankës. Banka, gjatë vitit 2021, ka qenë në pajtuëshmëri me kërkesat për implementimin e kontrolleve të brendshme. Si Departament i Pajtuëshmërisë së Përgjithshme, në vazhdimësi jemi angazhuar në procesin e trajnimit dhe vetëdijesimit të punonjësvë të Bankës lidhur me zbatimin e kërkesave të përditshme të cilat si institucion financiar bankar obligohemi t'i zbatojmë. Vlen të theksohet rëndësia që e ka zbatimi i kërkesave që dalin nga Kodi i Mirësjelljes, si dokument dhe kërkesë obliguese për zbatimin nga të gjithë të punësuarit e Bankës. Në kuadër të trajnimeve të mbajtura, po ashtu i është dhënë rëndësi e veçantë trajnimit të të punësuarve edhe për sa i përket rëndësisë së zbatimit të procedurave përkatëse që kanë të bëjnë me kërkesat për parandalimin e mashtrimit, si dhe rëndësisë së mbrojtjes së të dhënave personale.

Si kërkesë e veçantë ligjore, mbrojtja e të dhënave personale është njëra ndër përgjegjësitë fundamentale të çdo institucioni bankar, duke përfshirë edhe Bankën Ekonomike, dhe se informacionet që përpunohen në baza ditore janë thelbësore për të zhvilluar marrëdhënien afariste me klientët si dhe bashkëpunëtorët tanë. E drejta e privatësisë së individit është e drejtë e cila është e garantuar me Kushtetutë dhe ligje të Kosovës, si dhe të Evropës, andaj Banka Ekonomike respekton dhe zbaton në tërësi kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Krahas detyrave dhe përgjegjësiave të lartpërmendura, Departamenti i Pajtuëshmërisë së Përgjithshme tanimë në kuadër të saj ka edhe Njësinë për Trajtimin e Ankesave, të cilat çdoherë janë trajtuar me përkushtimin më të madh, duke pasur për bazë rëndësinë e tyre dhe që duhet trajtuar brenda afateve të përcaktuara ligjore. Kjo përgjegjësi padyshim se ka një rëndësi të madhe në zhvillimin dhe përmirësimin tutje të shërbimeve që ofron Banka Ekonomike.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS

Banka Ekonomike mbetet e përkushtuar që të japë kontributin e saj në përmirësimin e kushteve të komunitetit në përputhje me përgjegjësinë sociale të korporatës si një nga vlerat kryesore të institucionit.

Angazhimi ynë për 20 vite me radhë është fokusuar në projekte me karakter social, edukativ, mjedisor, shëndetësor, sportiv dhe kulturor. Të bindur që kur kombinojmë forcën e biznesit tonë, me dëshirën për të kontribuar për të mirën e komunitetit, i cili ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin dhe mirëqenien shoqërore, ne përmbushim edhe një nga objektivat tona për të pasur një rol aktiv në përmirësimin e jetës së komunitetit ku veprojmë.

Përgjatë 2021, kemi mbështetur mbi 30 iniciativa duke dëshmuar edhe njëherë që jemi një nga institucionet financiare me angazhimin më të madh në përgjegjësinë sociale të korporatës.

MBËSHTETJA PËR ASOCIACIONIN NACIONAL TË AUTIZMIT NË KOSOVË

Edhe gjatë vitit 2021, sikurse edhe vitet e kaluara, Banka Ekonomike në kuadër të përgjegjësisë sociale ka vazhduar me mbështetjen e kategorive shoqërore të cilat ndërlidhen me fëmijët, konkretisht edukimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.

Banka Ekonomike i është bashkuar kampanjës së iniciuar nga Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë, duke e mbështetur iniciativën përmes blerjes së punimeve të realizuara me shumë dashuri nga fëmijët me autizëm, përmes së cilës synohet krijimi i kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve për fëmijët, sipas nevojave terapeutike.

Aktivitetet e përgjithshme të ANAK përfshijnë: identifikimin e fëmijëve me autizëm, vlerësimin e shkathtësive të tyre, përgatitjen e planeve të punës, trajnimin e prindërve në ato plane të punës, ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme direkte ditore të nevojshme, rritjen e vetëdijesimit mbi autizmin dhe për shërbimet e nevojshme.





MBJELLJA E 540 DRUNJVE NË 27 KOMUNA TË KOSOVËS

Si Bankë me kapital 100 përqind vendor, rrjedhimisht mbajmë përgjegjësi sociale 100 përqind për këtë vend, andaj me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Bankës Ekonomike kemi vendosur që përmes një akti simbolik të mbjelljes së 20 drunjve në 27 komuna të Kosovës, gjithsej 540 drunj, të sensibilizojmë komunitetin lokal mbi rëndësinë e drunjve, gjelbërimit, ambientit në përgjithësi dhe duam po ashtu që të vazhdojmë të japim kontributin tonë të mëtejshëm në përmirësimin e mjedisit.

BANKA NË BASHKËPUNIM ME KLUBIN ALPIN PRISHTINA SURPRIZOJNË FËMIJËT E SHTRIRË NË KLINIKËN PEDIATRIKE

Banka Ekonomike së bashku me klubin Alpin Prishtina ka organizuar aktivitetin e lëshimit me litar nga objekti i Klinikës Pediatrike, me qëllim që gjatë lëshimit anëtarët e grupit Alpin Prishtina si dhe disa punonjës të Bankës Ekonomike të veshur si superheronjë t'i surprizojnë fëmijët.



Gjatë lëshimit me litar, përveç argëtimit të fëmijëve, janë ndarë edhe disa dhurata modeste për ta.

Gjatë këtij aktiviteti, Banka Ekonomike po ashtu ka dhuruar donacion për organizatën Care for Kosovo Kids, i cili do të destinohet për blerje të medikamenteve dhe pajisjeve të nevojshme për Klinikën Pediatrike.

Ky aktivitet nuk është aktiviteti i parë, pasi edhe në të kaluarën kemi mbështetur Klinikën Pediatrike, por nuk do të jetë as i fundit.



MBËSHTETJA PËR SPORTIN

Për 20 vite, si Banka e vetme me kapital 100% vendor, kemi qenë partner dhe mbështetës i shumë kategorive shoqërore, e një nga këto edhe sporti.

Duke parë nevojën për mbështetje të klubeve sportive, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për punë, veçanërisht me talentet e rinj, kemi vazhduar me mbështetjen e 15 klubeve sportive në mbarë Kosovën, si: 3X3 Prishtina street ball, kampionatin shtetëror të Kosovës në Golf, FC Ferizaj, FC 2 Korriku, Klubi i volejbollit të femrave M-Technologie, KF Llapi, Klubi i boksit Gollaku, Klubi i basketbollit për femra PENZA, Klubi i pingpongut Lidhja e Prizrenit, KF Trepca 89, KB Trepca, FC Malisheva dhe KB Rahoveci si dhe klube të futbollit, basketbollit, hendbollit, volejbollit, golfit, alpinizmit etj.

Sporti, përveç shumë përfitimeve tjera, ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në shëndetin fizik dhe mendor, andaj do të mbetet një nga fokuset tona edhe në të ardhmen. Përmes mbështetjes së sportit, përveç tjerash synojmë të ndihmojmë masivizimin e mëtejshëm të sportit.





DHURIMI I GJAKUT

20 vite përmes aktiviteteve të ndryshme kemi ndihmuar në përmirësimin dhe vetëdijësimin për të krijuar një ambient social më të mirë për të gjithë.

Banka Ekonomike në bashkëpunim me Transfuzionin e Gjakut ka organizuar aktivitetin e dhurimit vullnetar të gjakut, aktivitet tashmë tradicional.

Shëndeti publik, veçanërisht në situatën me pandeminë, është një nga gjërat më të rëndësishme, andaj dhurimi vullnetar i gjakut si simbolikë është i rëndësishëm veçantë dhe jetik për jetën e njeriut.



MBËSHTETJA PËR GRATË

Banka Ekonomike vazhdon t'i mbështesë gratë me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së tyre që të krijohen fushata të përqendruara në frymëzim, mirëqenie dhe shëndet mendor.

Në sheshin "Nëna Terezë" është mbajtur sesioni i jogës, nën drejtimin e organizatës "She Inspires". Qëllimi i këtij programi ishte i shumëfishtë, duke marrë parasysh rrethanat e krijuara nga pandemia, shëndeti mendor dhe fizik është çelësi i mirëqenies së një personi dhe synojnë të festojnë ditën e mirëqenies globale.

Ngjarja bashkoi të gjitha gratë me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së tyre dhe të rinjve që kalojnë kohë të vështira gjatë pandemisë, që të krijohen fushata të përqendruara në frymëzim, mirëqenie dhe shëndet mendor.



MBËSHTETJA PËR SHOQATËN E TË VERBËRVE

Banka Ekonomike ka vazhduar me ofrimin e mbështetjes për kategoritë shoqërore të cilat kanë nevojë për kujdes të veçantë, duke synuar përbushjen e misionit për përgjegjësinë sociale. Në këtë drejtim, Banka Ekonomike i është bashkuar kampanjës #Një dritë në fund të tunelit, të iniciuar nga Shoqata e të Verbërve Gjakovë, duke dhuruar donacion për të mbështetur rehabilitimin dhe shkollimin e personave të verbër në Komunën e Gjakovës.

Shoqata e të Verbërve Gjakovë është e themeluar në vitin 1947 dhe përmes këtij donacioni do të krijohen mundësi më të mira për personat e verbër në mësim, shkrim dhe lexim, veçanërisht në Bril dhe sistemin e të folurit "Gjoiz".



UDHËTIMI I STAFIT NË STAMBOLL

Punonjësit janë shtylla kryesore e ndërtimit dhe zhvillimit të një institucioni. Të tillë janë edhe Syzana, Lindita, Bekimi, Kujtimi, Klara, Ajetja, Agroni, Afijetja dhe Merita të cilët për 20 vite kontribuan në Bankën Ekonomike, si punonjës të dalluar.

Me rastin e 20-vjetorit, Banka Ekonomike organizoi një udhëtim në Stamboll për punonjësit tanë të cilët dhanë kontributin e tyre për 20 vite në Bankën tonë.

Si Banka e vetme 100% vendore, zhvillimin dhe rritjen tonë e kemi mbështetur në punonjës të përkushtuar e profesionalë.



TETORI ROZË

Në kuadër të muajit tetor, si muaji ndërkombëtar i vetëdijesimit kundër kancerit të gjirit, Banka Ekonomike i është bashkuar fushatës duke organizuar ligjëratë për punonjëset e Bankës me temën "Zbulimi i hershëm SHPËTON Jetë".

Përmes këtij organizimi u theksua rëndësia që ka zbulimi i hershëm dhe kujdesi që duhet të i kushtojmë shëndetit tonë.



MBËSHTETJA E AKTIVITETIT KULTUROR PRITE N'SHESH

Në kuadër të mbështetjes së aktiviteteve kulturore dhe sportive, gjatë fundvitit kemi mbështetur aktivitetin kulturor tradicional Prite n'Shesh, i cili u organizua nga Komuna e Prishtinës dhe Kanal10.

Festat e fundvitit na sjellin energji pozitive, andaj edhe jemi kujdesur të mbështesim aktivitetet të cilat ngjallin optimizëm dhe festë në shoqërinë tonë.



BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)

PËRMBAJTJA

Raporti i Auditorit të Pavarur	77
Pasqyra e Pozicionit Financiar	80
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	82
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	84
Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë	85
Shënime për Pasqyrat Financiare	87-181

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Banka Ekonomike Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Ekonomike Sh.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin '*Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditor tjetër që ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 19 April 2021.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Banka të ndërpres veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

12 Prill 2022

Sadik Berisha

Partner i Angazhimit

Pasqyra e Pozicionit Financiar*(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)*

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	6	29,081	24,860
Balanca me Bankën Qendrore të Kosovës	7	78,542	57,530
Kreditë për klientët	8	329,296	247,123
Investime në letra me vlerë	9	5,000	25,365
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	10	13,796	8,768
Pasuri të paprekshme	11	3,949	2,813
Pasuri të tjera	12	1,120	1,423
Gjithsej pasuritë		460,784	367,882
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	13	411,106	330,281
Detyrime ndaj bankave	14	1,086	2,080
Detyrimi tatimor		253	6
Detyrime të tjera	15	2,542	2,183
Detyrimi i shtyer tatimor		608	-
Gjithsej detyrimet		415,595	334,550

Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	16	29,422	29,422
Rezerva e rivlerësimit	16	4,794	63
Fitime të mbajtura		10,973	3,847
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		45,189	33,332
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		460,784	367,882

Shënimet shoqëruese nga 77 në 112 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre me 11 Prill 2022:



Z. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv



Z. Fitim Rexhepaj
Zyrtar Kryesor për Financa

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse*(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)*

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	18	21,512	17,965
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	18	(2,838)	(2,714)
Të ardhurat neto nga interesi		18,674	15,251
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	19	3,660	2,748
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	19	(1,300)	(825)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione		2,360	1,923
Të ardhurat e tjera operative	20	1,907	1,117
Humbja/fitimi neto nga këmbimi valutor		(101)	49
Të ardhurat		22,840	18,340
Shpenzimet e personelit	21	(3,890)	(3,466)
Zhvlerësimi i pasurive, pajisjeve dhe ROU	10	(1,994)	(1,975)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	11	(373)	(302)
Shpenzime të tjera	22	(6,427)	(4,985)
Humbjet neto nga zhvlerësimi për kreditë	8	(2,273)	(3,133)
Gjithsej shpenzimet operative		(14,957)	(13,861)
Fitimi para tatimit		7,883	4,479
Tatimi në fitim	23	(805)	(470)
Fitimi neto për vitin		7,078	4,009

Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje			
Përfitimi në rivlerësimin e tokës dhe ndërtesës, neto nga tatimi		4,725	-
Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje			
Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		54	(309)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		11,857	3,700

Shënimet shoqëruese nga 77 në 112 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet*(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej ekuiteti dhe rezervat
Me 01 Janar 2020	27,761	372	5,199	33,332
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	3,361	-	(3,361)	-
Dividenda e shpërndarë	-	-	(2,000)	(2,000)
Tërheqja e kapitalit aksionar	(1,700)			(1,700)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	1,661		(5,361)	(3,700)
Fitimi për vitin	-	-	4,009	4,009
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin				
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	(309)	-	(309)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	(309)	4,009	3,700
Më 31 Dhjetor 2020	29,422	63	3,847	33,332
Me 01 Janar 2021	29,422	63	3,847	33,332
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	-	-	-	-
Dividenda e shpërndarë	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	7,078	7,078
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin				
Rivlerësimi i pronës (neto nga tatimi)	-	4,725	-	4,725
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	54	-	54
Transfer	-	(48)	48	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	4,731	7,126	11,857
Më 31 Dhjetor 2021	29,422	4,794	10,973	45,189

Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë*(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)*

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Aktivite operative			
Fitimi para tatimit		7,883	4,479
Ndryshime për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	2,367	2,277
Humbje neto nga dëmtimi i kredive për klientët	8	2,273	3,133
Ngarkesa / (lirimi) i provizionit për garancitë	20	10	(3)
Të ardhurat nga interesi	18	(21,512)	(17,965)
Shpenzimet e interesit	18	2,838	2,714
Humbje para ndryshimeve në aktivite operative		(6,141)	(5,365)
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
Rezerva statutore me BQK-në	6	(5,246)	(3,147)
Kredi për klientët	8	(83,634)	(40,619)
Pasuri të tjera	12	303	764
Detyrime ndaj klientëve	13	80,855	47,599
Detyrime ndaj bankave	14	(994)	(20)
Detyrime të tjera	16	699	(145)
		(14,158)	(933)
Interesi i paguar		(2,868)	(2,282)
Interesi i arkëtuar		20,700	16,516

Tatim mbi të ardhurat i paguar		(621)	(866)
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga/ (përdorur në) aktivitetet operative		3,053	12,435
Aktivite investuese			
Blerja e pronave, pajisjeve dhe pasuritë e paprekshme	10,11	(2,607)	(3,223)
Kthimet (blerjet) neto të letrave me vlerë		(21,687)	(27,039)
Zvogëlimi në letrat me vlerë		42,052	36,395
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar / (përdorur) nga aktivitetet investuese		17,758	6,133
Aktivitetet financiare			
Shlyerja e borxhit		-	(1,050)
Shlyerja e detyrimit të qirasë		(825)	(727)
Dividentët e paguar		-	(2,000)
Tërheqja e kapitalit aksionar		-	(1,700)
Neto rrjedha e parasë (e përdorur) në aktivitetet financiare		(825)	(5,477)
Rritja / (ulja) neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		19,986	13,091
Paraja dhe ekuivalentët e saj, fillim të vitit	6	59,671	46,580
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	6	79,657	59,671

Shënimet shoqëruese nga 77 në 112 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. HYRJE

Banka Ekonomike Sh.a ("Banka") është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 qershor 2001. Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve të saj në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përpiluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e tij të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Standardet dhe interpretimet e reja të adoptuara nga Banka

Banka ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Adoptimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk pati ndikim signifikant në pasqyrat financiare të bankave.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 janar 2021

- Koncesionet e qirasë të lidhura me COVID-19 pas datës 30 qershor 2021 (Ndryshimet në SNRF 16).
- Faza 2 e Reformës së Standardit të Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16).

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(c) Standardet dhe interpretimet e reja të cilat nuk janë ende efektive

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por të cilat nuk janë ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Bankës janë shpalosur më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kornizën Konceptuale
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata të rënda - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente (ndryshime në SNK 1)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet nga një transaksion i vetëm

Banka parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

(d) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare të listuara më poshtë, të cilat maten me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura nën modelin e biznesit të mbajtur për të mbledhur dhe shitur.

(e) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në euro, që është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt, përveç ku shprehet ndryshe.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(f) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive. Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 26.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare. Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet në paraqitje për vitin aktual.

(a) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që saktësisht zbret pagesat në të holla ose faturat e ardhshme të parashikuara gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar (ose, sipas rastit, një periudhe më të shkurtër):

- vlera kontabël bruto e aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë. Për aktivet financiare të dëmtuara nga kreditë, një normë efektive e interesit të rregulluar nga kredia llogaritet duke përdorur flukset monetare të ardhshme të vlerësuara duke përfshirë humbjet e pritshme të kredisë. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifat e transaksionit dhe pikat e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi financiar ose detyrimi financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet ndaj vlerës kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është i dëmtuar nga kredia) ose ndaj koston së amortizuar të detyrimit.

Sidoqoftë, për aktivet financiare që kanë pësuar rënie të kredisë pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk është më i dëmtuar nga kredia, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi rikthehet në bazë bruto.

Për aktivet financiare të cilat kanë pësuar zhvlerësim të kredisë në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit të rregulluar nga kredia në koston e amortizuar të aktivit. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto, edhe nëse rreziku i kredisë së aktivit përmirësohet.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të Të ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse (ATGJ) përfshijnë:

- Interesi mbi aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- Interesi për instrumentet e borxhit të matur në VDATGJ llogaritur në bazë të interesit efektiv.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një pasurie ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit e (shih (a)).

Të ardhurat e tjera nga tarifa dhe komisionet, përfshirë edhe tarifën e shërbimeve të llogarive, tarifën e transferimit të fondeve, komisione shitjesh dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse, njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

(c) Pagesat e qirasë

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e gjithsej shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

(d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë të tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të pasqyronin mënyrën në të cilën Banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendosë vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur ato rimerren, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Mjetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlihen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor. Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendit nga ana e Bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendin respektiv.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura, kreditet tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshme, vetëm në atë masë që është e mundur të gjenerohen fitime të ardhshme të tatueshme përkundrejt të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në secilën datë të raportimit dhe reduktohet në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**(e) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj rivlerësohen në monedhën funksionale përkatëse të Bankës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në po atë datë.

Fitimi ose humbja nga zërat monetarë përfaqëson diferencën ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit.

Pasuritë dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Zërat jomonetarë që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare*(i) Njohja*

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat dhe huamarrjet dhe borxhet e varura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

*(ii) Klasifikimi***Pasuritë financiare**

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDNFH.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja këto kushte dhe është

nuk është caktuar si në VDNFH:

Detyrimet ndaj bankave prej 1,086 mijë euro (2020: 2,080 mijë euro) përfaqësojnë llogari rrjedhëse me bankat vendase. Llogaritë rrjedhëse nuk bartin interes.

15. Detyrimet tjera

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Shpenzimet e llogaritura	666	45
Taksa tjera të pagueshme	33	52
Të pagueshme për pension dhe asistencë sociale	30	38
Të hyrat të tjera të shtyera	76	77
Provizione për humbje nga garancitë	22	12
Detyrimet e qirasë (Nota 10)	1,458	1,954
Provizione për çështje gjyqësore	257	5
Gjithsej	2,542	2,183

Lëvizjet për provizionet për humbje nga garancitë e lëshuara nga Banka janë si vijon:

	2021	2020
Provizionet më 1 janar	12	6
Kthimi/Provizioni gjatë vitit (Shënimi 20)	10	6
Provizionet më 31 dhjetor	22	12

16. Ekuiteti dhe rezervat

Ekuiteti i nënshkruar dhe paguar i Bankës përbëhet nga 114,930 aksione të zakonshme (2020: 114,930 aksione të zakonshme) me vlerë nominale 256 euro secili (2020: 256 euro). Struktura aksionare e Bankës është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021		Më 31 dhjetor 2020	
	%	Shuma	%	Shuma
Behgjet Pacolli	35	10,246	35	10,246
Immobiliare Red Llc	29	8,402	29	8,402
Selim Pacolli	18	5,360	18	5,360
Xhabir Kajtazi	12	3,482	12	3,482
Ismet Gjoshi	3	987	3	987
Hasan Hajdari	1	297	1	297
Zyhra Hajdari	1	285	1	285
Të tjerët me më pak se 1%	1	363	1	363
	100	29,422	100	29,422

Shpërndarja e fitimit dhe dividendat e deklaruar

Mbajtësit e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë kur deklarohen herë pas here dhe kanë të drejtën e një vote për aksion.

Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Bankës, yt

Gjatë vitit që përfundoi në 31 dhjetor 2021 Banka mbajti në Fitim të Mbajtur fitimin e vitit 2020 dhe nuk alokoi në kapitalin aksionar si dividendë në aksione, (2020: Banka alokoi në kapitalin aksionar si dividendë në aksione shumë prej 3,361 mijë euro. Për më tepër, gjatë vitit 2020, bazuar në vendimin e Bankës për shpërndarjen e fitimit dhe bazuar në një Vendim të BQK-së të datës 16 dhjetor 2020 për "Miratimin e kërkesës së Bankës Ekonomike për pagesën e dividendit dhe tërheqjen e kapitalit aksionar", banka pagoi dividendë në shumë prej 2,000,000 euro nga fitimi i pashpërndarë, ndërsa shuma prej 1,700,000 euro u tërhoq nga kapitali aksionar.)

Në përputhje me ligjin nr.04/L-093 për "Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Financiare Jobankare" minimumi i kapitalit të paguar për bankat vendase që veprojnë në Kosovë është 7 milion euro.

Rezervat e rivlerësimit

Lëvizjet në rezervën e rivlerësimit janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Rezerva e rivlerësimit më 1 janar	63	372
Rivlerësimi i pronës (pa taksa)	4,725	-
Rezerva e rivlerësimit e investimeve në LV	54	(309)
Transferimi në fitimin e pashpërndarë	(48)	-
Balanca me 31 dhjetor	4,794	63

17. Te ardhurat neto nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv

Te ardhurat nga interesi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Kredi dhënë klientëve	21,011	17,331
Depozitat dhe llogaritë me bankat	16	17
Investime në letra me vlerë	485	617
Gjithseji i të ardhurave nga interesi	21,512	17,965
Shpenzimet e interesit		
Depozita të klientëve	(2,783)	(2,616)
Borxhi i varur	-	(24)
Interesi mbi detyrimet e qirasë SNRF 16	(55)	(74)
Gjithseji i shpenzimeve të interesit	(2,838)	(2,714)
Te ardhurat neto nga interesi	18,674	15,251

18. Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Shërbimet bankare	3,562	2,667
Garancitë	98	81
Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet	3,660	2,748
Shpenzime për Swift	(783)	(537)
Tarifa për liçensë dhe tarifa të tjera rregullatore	(517)	(288)
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(1,300)	(825)
Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	2,360	1,923

19. Të ardhura të tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Kthimet e kredive që janë shlyer më pare	1,356	865
Ngarkesa/(Zvogëlimi) provizioneve për humbje nga garancitë	(10)	(6)
Të ardhurat nga shitja e investimeve	400	165
Të ardhura të tjera	161	93
Gjithsej	1,907	1,117

20. Shpenzimet e personelit

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Paga dhe rroga	3,637	3,221
Kontribute për pension	175	163
Kompensime të tjera	78	82
Gjithsej	3,890	3,466

21. Shpenzimet e tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Sigurimi	1,144	1,133
Shpenzimet operacionale Mastercard	628	475
Riparimet dhe mirëmbajtja	872	641
Tarifat e sigurimit të depozitave	600	510
Shërbime të TI	679	435
Shërbime komunale dhe karburanti	253	316
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	325	201
Tarifa ligjore dhe profesionale	267	295
Shërbimet për mbledhjen e kredive	91	53
Komunikimi	135	93
Materialet për zyrë	42	45
Printime	42	15
Udhëtime	6	6
Shpenzimet e tarifave në lidhje me FKGK	112	68
Zhvlerësim për asete të tjera	106	-
Shpenzimet e çështjeve gjyqësore	252	-
Shpenzimet e çregjistrimit dhe shitjes së paisjeve	168	4
Shpenzimet e përfaqësimit	50	38
Shpenzimet lidhur me konsulencën	159	147
Sponsorizimi – lejohet për qëllime tatimore	163	-
Të tjera	333	510
Gjithsej	6,427	4,985

22. Shpenzimet e tatimit në fitim

Tatim fitimi në Kosovë llogaritet në shkallën 10% (2020: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

Në vijim paraqitet një barazim i rezultatit kontabël me tatimin në fitimin:

	2021	2020
Ftimiti para tatim fitimit (duke përjashtuar sponsorizimin)	8,046	4,479
Tatimi në shkallën 10%	805	448
<i>I rregulluar për:</i>		
Shpenzime jo të zbritshme	263	220
Shpenzime interesi shtesë të zbritshme	(14)	(15)
Të ardhura jo të tatueshme	(88)	(78)
Lejime per kredi	(150)	(175)
Shpenzimet e lejuara të interesit	52	70
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	868	470
<i>Shkalla efektive e taksave</i>	10.79%	10.5%
Sponsorizimi në kulutrë dhe sport (deri në 20% të shpenzimit të tatimit në fitim)	(163)	-
Shpenzimi i tatimit në fitim	705	470
Ngarkesa e tatimit të shtyrë	100	-
Shpenzimi i tatimit në fitim i njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve	805	470

23. Zotimet dhe kontingjencat

Banka lëshon garanci për klientët e saj. Këto instrumente kanë një rrezik kredie të ngjashëm me atë të kredive të dhëna klientëve. Bazuar në vlerësimin e menaxhmentit, nuk do të lindin humbje materiale në lidhje me garancitë e papaguara më 31 dhjetor 2021.

Garancitë	2021	2020
Siguruara me depozita	891	405
Siguruara me kolateral tjetër	2,652	1,889
	3,543	2,294
Zotimet kreditore		
Kreditë e aprovuara por jo të lëshuara	4,741	1,085
Mbitërheqjet	18,990	12,783
Kredit kartela	2,299	1,699
Objektet e kartës së kreditit të papërdorur	26,031	15,567

Kolaterale të tjera të zotuar për garanci, përfshijnë kryesisht pronat e pengut dhe të pasurive të paluajtshme. Zotimet përfaqësojnë bilancet e huaja të kredive, mbitërheqje dhe kufizimet e kartave që u jepen klientëve.

Çështjet gjyqësore

Më 31 dhjetor 2021, Banka ka njohur provizione në vlerë prej 257 mijë euro. (31 dhjetor 2020: 8 mijë euro), në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti beson se provizionet e njohura janë një vlerësim i arsyeshëm për përfundimin e padive në vazhdim më 31 dhjetor 2021.

24. Transaksionet me palët e lidhura

Në përputhje me SNK 24 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura", një palë e lidhur është çdo palë që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Transaksionet me palët janë bërë në kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet në treg

Në rrjedhën e kryerjes së aktiviteteve bankare, Banka hyn në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe gjendjet me aksionarët dhe individët apo shoqëritë e tjera të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Pasuritë	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesor dhe palët e lidhura		Gjithsej	
	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<i>Kredi dhënë klientëve</i>								
Kredi dhënë klientëve, net	44	-	82	80	10,318	6,364	10,444	6,444
Pasuritë e pa-prekshme (në progres)	-	-	-	-	3,158	2,147	3,158	2,147
Gjithsej pasuritë	44	-	82	80	13,476	8,511	13,602	8,591
Detyrimet								
Detyrime ndaj klientëve	(12)	(16)	(70)	(79)	(26,221)	(19,916)	(26,303)	(20,011)
Gjithsej detyrimet	(12)	(16)	(70)	(79)	(26,221)	(19,916)	(26,303)	(20,011)
Garancitë	-	-	-	-	227	198	227	198
Gjithsej gjendja jashtëbilancore	-	-	-	-	227	198	227	198

Vlera totale e vlerësuar e kolateralit duke llogaritur edhe garancionet, përfituar nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 ishte 22,189 mijë euro (Më 31 dhjetor 2020 vlera e tillë e vlerësuar ishte 23,710 mijë euro).

Angazhimet e papërdorura për kredi me palët e lidhura më 31 dhjetor 2021, janë 845 mijë euro (2020: 358 mijë euro).

Depozitat e palëve të lidhura përbëjnë 6.38 % (2020: 6.02 %) të gjendjes totale të depozitave të klientëve.

Transaksionet me palët e lidhura gjatë 2021 dhe 2020 janë si në vijim:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesorë dhe palët e lidhura me ta		Gjithsej	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Të hyrat nga interesi	3	-	4	6	300	283	307	289
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	0	-	1	-	57	38	58	38
Shpenzimet e interesit	-	-	0	-	(41)	(20)	(41)	(20)
Shpenzimet e implementimit-BV	-	-	-	-	(532)	(354)	(532)	(354)

Shpërblimi gjithsej për menaxhmentin kyç të Bankës është si në vijim:

	2021	2020
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për Bordin Drejtues	78	77
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për menaxhmentin kyç	208	232
	286	309

25. Menaxhimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje dhe përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiarë:

- Rreziku i tregut
- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit

Struktura për menaxhimin e rrezikut

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit rrezik më sipër, objektivave, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe menaxhimin e kapitalit të saj.

Bordi i Drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka themeluar

Komitetin e Pasurive dhe Detyrimeve ("ALCO"), Komitetin e Likuiditetit, Komitetin e Kredive, Komitetin e Auditimit, dhe Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të Bankës mbi menaxhimin e rrezikut në fushat e tyre specifike. Të gjitha Komitetet e Bordit të Drejtorëve kanë anëtar ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Banka, për të përcaktuar limitet dhe kontrollat e rrezikut, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe shërbime të ofruara.

Banka synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolin dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit për menaxhimin e rrezikut në raport me rreziqet me të cilat përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikime në mënyrë të rregullta dhe spontane të kontrollit dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit. Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe merr masat e përshtatshme në lidhje me rrezikun e kredisë, të tregut (normës primare të interesit) dhe likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet negative të mundshme nga kriza financiare dhe ekonomike globale. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut, duke mbajtur një pozicion të mjaftueshëm likuid dhe të kapitalit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Bankës nëse një klient ose kundërparti e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me kredi dhe paradhënie ndaj klientëve dhe bankave të tjera. Për qëllime të raportimit financiar Banka merr në konsideratë dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (rreziku i mospagës të huamarrësit individual, rreziku i vendit dhe rreziku i sektorit).

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë përgjegjësinë për monitorimin e rrezikut të kredisë. Një departament të veçantë i Rrezikut të kredisë është përgjegjës për administrimin e rrezikut të kredisë të Bankës. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë për huamarrësit nga Komiteti i Rrezikut kryhet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë së huamarrësit. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë gjithashtu menaxhohet pjesërisht duke përfituar kolateral dhe garanci.

26. Manaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e cilësisë së kredisë**

Tabelat më poshtë paraqesin informacione mbi cilësinë kreditore të asetet financiare dhe zbritjet për zhvlerësime/humbje krijuar nga Banka kundrejt këtyre pasurive. Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë për Bankën më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, pa marrë në konsideratë ndonjë kolateral të mbajtur ose mbrojtje të tjera ndaj rrezikut të kredisë. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu siç është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Kredi dhe paradhënia për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020
<i>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë</i>								
Vlera e bartur	329,296	247,123	5,000	25,365	94,236	70,263	-	-
	329,296	247,123	5,000	25,365	94,236	70,263	-	-
<i>Me kosto të amortizuar</i>	340,080	257,133	5,000	25,365	94,236	70,263	-	-
Lejimet për zhvlerësim	(10,784)	(10,010)	-	-	-	-	-	-
Vlera kontabël neto	329,296	247,123	5,000	25,365	94,236	70,263	-	-
							-	-
<i>Jashtë bilancit: ekspozimi maksimal</i>							-	-
Garanci financiare: rrezik i ulët/i pranueshëm	26,031	15,567	-	-	-	-	3,543	2,294
Gjithsej Angazhime/garanci	26,031	15,567	-	-	-	-	3,543	2,294
Provizionet e njohura si detyrim	-	-	-	-	-	-	(22)	(12)
Gjithsej Ekspozimi	26,031	15,567	-	-	-	-	3,521	2,281

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

	2021				2020			
Kredi dhe paradhënie klientëve	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej kreditë	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej kreditë
Gjithsejt shuma bruto	110,571	101,085	128,424	340,080	93,536	68,499	95,098	257,133
Lejimet për zhvlerësim	(2,570)	(4,872)	(3,342)	(10,784)	(4,479)	(3,630)	(1,901)	(10,010)
Vlera kontabël neto	108,001	96,213	125,082	329,296	89,057	64,869	93,197	247,123
<i>Me kosto të amortizuara</i>								
Standarde	107,653	86,441	116,428	310,522	91,057	64,751	91,231	247,039
Në vëzhgim	351	593	11	955	355	494	1,938	2,787
Sub-standarde	684	10,709	7,859	19,252	441	335	195	972
Të dyshimta	578	1,021	461	2,060	536	942	131	1,608
Humbje	1,305	2,321	3,665	7,291	1,147	1,977	1,603	4,727
Gjithsejt bruto	110,571	101,085	128,424	340,080	93,536	68,499	95,098	257,133
Gjithsej lejimet për provizione	(2,570)	(4,872)	(3,342)	(10,784)	(4,479)	(3,630)	(1,901)	(10,010)
<i>Kreditë me kushte të rinegociuara</i>								
Vlera kontabël	350	1,997	1,771	4,118	402	1,217	2,237	3,856
Lejimet për provizionim	(60)	(720)	(849)	(1,629)	(173)	(975)	(420)	(1,568)
Vlera kontabël neto	290	1,277	922	2,489	229	241	1,817	2,288
<i>Kreditë në vonesë</i>								
Jo në vonesë	105,464	91,944	123,441	320,849	88,855	60,697	88,392	237,944

Në vonesë 1-30 ditë	3,091	5,396	1,351	9,838	2,850	4,626	4,438	11,915
Në vonesë 31 - 90 ditë	531	1,263	481	2,275	424	627	619	1,670
Në vonesë 91 – 365 ditë	658	886	1,671	3,215	604	744	141	1,489
Në vonesë mbi 365 ditë	827	1,596	1,480	3,903	802	1,805	1,508	4,115
	110,571	101,085	128,424	340,080	93,536	68,499	95,098	257,133

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Zhvlerësime dhe provizionime

Provizionet Gjithseje që kërkohen nga SNRF-të për "Menaxhimin e Rrezikut Kreditor" (shih 3. (f)(vii)) përfshijnë humbje të ndodhura/pësuar në datën e raportimit (modeli i humbjes së shkaktuar) dhe humbjet e pritshme.

Banka vlerëson probabilitetin e dështimit në pagim të kundërpalëve, duke përdorur mjete të brendshme rangimi/renditje të përshtatshme për kategori të ndryshme kundërpalesh. Mjete të tilla kombinojnë analizën dhe gjykimin dhe janë të vlefshme, kur është e përshtatshme, duke u krahasuar me të dhëna të jashtme të disponueshme.

Kundërpalët janë segmentuar në pesë kategori dhe klasifikimi i Bankës, i cili është treguar më poshtë, reflekton intervalin e probabilitetit të dështimit, të përcaktuar për çdo kategori. Ekspozimet lëvizin midis kategorive kur vlerësimi i probabilitetit të dështimit ndryshon. Mjetet e rankimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, përmirësohen dhe validohen nga Banka.

Kreditë janë ranguar nga A në E në sistemin e brendshëm të rangimit të rrezikut të kredisë:

- A Standarde
- B Vrojtuese
- C Nënstandarde
- D Të dyshimta
- E Të humbura

Banka raporton klasifikimin e humarrësve të saj, tek BQK dhe Regjistri i Kredisë së Kosovës. Politika e provizionimit për këto kredi është detajuar në shënimin 3. (f) (viii).

Vlerësimet individuale dhe kolektive të portofolit të kredisë

Për qëllime të manaxhimit të brendshëm, Banka veçon kreditë në kredi që vlerësohen individualisht për zhvlerësim: këto janë kredi të klasifikuara si nënstandarte ose më ulët. Të gjitha kreditë e tjera analizohen kolektivisht/në grup për qëllime të vlerësimit për zhvlerësim.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Banka vlerëson HPK (humbjet e pritshme të kredisë) mbi baza individuale për ekspozimet e papaguara më të mëdha se 100 mijë euro që klasifikohen në fazën 3 në bazë mujore, ndërsa me NEI diskonton fluksin e parashikuar të parave. Për më tepër, ekspozime të tilla monitorohen nga afër nga Banka dhe raportohen për shkak të madhësisë së tyre dhe ndikimit të mundshëm në fitimin ose humbjen e Bankës. (2020: 100 mijë euro të paktën një herë në muaj kur rrethanat individuale e kërkojnë atë).

Kreditë në vonesë por të pazhvlerësuara

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesat kontraktuale ose pagesat e principalit janë të skaduara, por Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Politika e fshirjes

Banka fshin një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi i fshirjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin Gjithsej. Shuma gjithseje e fshirë gjatë vitit 2021, është 1,499 mijë euro (2020: 403 mijë euro).

Depozita nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe i menaxhmenti kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's. Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim Gjithsej të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalojnë 15% të kapitalit rregullator të klasit të parë. Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Më 31 dhjetor	2021	2020
AAA+ to BBB-	8,854	8,316
A+ to A-	1,052	168
BB+ to B-	619	118
BBB+ to B-	-	701
Të pa ranguara	1,398	435
Bankat vendore	3,772	2,995
	15,694	12,733

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

25. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Angazhimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shuma e plotë e angazhimit.

Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat e zbutjes

Banka menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë, kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale, me grupet dhe me degët.

Banka strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Banka mban kolateral kundrejt kredive dhe paradhënies ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi aktive të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi dhe paradhënie ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

	2021		2020	
	Kredi dhe paradhënie klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit	Kredi dhe paradhënie klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit
Hipoteka	115,325	446,444	71,941	324,296
Kolateral në mjete monetare	10,092	10,092	7,316	7,316
Pengje	147,657	264,458	112,486	222,275
Miks (hipoteke dhe peng)	57,044	296,174	57,958	306,564
Pa kolateral	9,962	-	7,432	-
Gjithsej	340,080	1,017,168	257,133	860,451

Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Më 31 dhjetor 2021, Banka ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë. Ekspozimi më i lartë ishte në: 12.33%, gjithsej ishin dy ekspozime ndaj kredive që tejkalonin 10% të kapitalit të nivelit të parë (2020: 13.13%, katër ekspozime të kredive). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021, përfaqëson 27.06% (2020: 23.38%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 7.26% (2020: 8.76%) të kapitalit të nivelit të parë.

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimin të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)****Përqendrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)**

	Kredi dhe paradhënia për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Përqendrimi sipas sektorëve								
Korporata	125,082	93,197	-	-	-	-	1,892	1,484
Qeveria	-	-	5,000	25,365	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	94,236	70,263	-	-
Individët	108,001	89,057	-	-	-	-	-	-
Mikro bizneset	96,213	64,869	-	-	-	-	1,650	810
Gjithsej	329,296	247,123	5,000	25,365	94,236	70,263	3,543	2,294
Përqendrimi sipas vendndodhjes								
Vendet e BE	-	-	-	-	11,823	9,638	-	-
Republika e Kosovës	329,296	247,123	5,000	25,365	82,413	60,625	3,543	2,294
Gjithsej	329,296	247,123	5,000	25,365	94,236	70,263	3,543	2,294

Rreziqet që lidhen me COVID-19

Banka po ndjek në vazhdimësi zhvillimet në lidhje me pandeminë COVID 19, ndonëse situata me Covid në vitin 2021 ka qenë më e lehtë. Gjatë gjysmës së parë të vitit kanë nisur këstet e para të kredive të riprogramuara në fazën e dytë gjatë vitit 2021, ku është vërejtur një përmirësim i situatës financiare të të gjithë sektorëve të ekonomisë, gjithashtu PBB gjatë tremujorit të katërt ka arritur në 6.36%, krahasuar me në të njëjtin tremujor të një viti më parë dhe klientët nuk kanë pasur probleme me shlyerjen e kredisë.

Pozicioni financiar i bankës vijon të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vihet re në rritjen e kredive dhe depozitave, si në të ardhura nga interesi, ashtu edhe në të ardhura nga tarifat dhe komisionet. Bazuar në të dhënat aktuale dhe zhvillimet aktuale, Banka vazhdon të jetë mbi kërkesat për kapital dhe më 31 dhjetor 2021, mjaftueshmëria e kapitalit është 13.56% dhe kërkesat e nivelit të likuiditetit 34.84%.

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që flukset monetare të ardhshme do të luhaten nga ndryshimet e normës së interesit të tregut dhe rreziku që maturiteti i aktiveve interesprurëse ndryshon nga maturiteti i detyrimeve interesmbartëse të përdorura për të financuar këto aktive. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar, tregon se deri në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivitetet dhe depozitat e konsumatorëve kanë norma fikse interesi.

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivitetet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Banka përpiqet të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

Ekspozimet e Bankës janë të bazuara normat e interesit të shënuara të Kosovës dhe Banka ballafaqohet vetëm me rrezik të rivënjes së çmimit.

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Bankës në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Departamenti i Rrezikut në një bazë të vazhdueshme monitoron rrezikun e normave të interesit përmes monitorimit të kushteve të tregut dhe duke marrë vendime të nevojshme të ri-çmimit ose rialokimit me miratimin e Komitetit të Pasurive dhe Detyrimeve. Një raport në lidhje me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komitetit të Pasurive dhe Detyrimeve. Masat e nevojshme merren nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analizë mbi depozituesit e mëdhenjë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet dhe analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analiza të rrezikut të likuiditetit, etj.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivitetet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e riçmimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të

optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Bankës. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të aktiveve dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si në vijim:

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

	USD		EUR		CHF	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Asetet						
Paraja e gatshme dhe në banka	0.40	0.88	(0.57)	(0.24)	(1.62)	(1.55)
Gjendja me BQK	-	-	(0.63)	(0.60)	-	-
Kredi klientëve	-	-	6.64	7.10	-	-
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	3.25	-	-
Investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	1.00	1.26	-	-
Detyrimet						
Depozita të klientëve	1.66	-	0.63	0.80	-	-
Borxhi i varur	-	-	-	7.50	-	-

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendeikut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në lakoren e pëqindjeve dhe një pozitë financiare të qëndrueshme) është si vijon:

Efekti i vlerësuar i fitimit (humbjes)	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp	100 bp	100 bp	100 bp
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
2021	(145)	(99)	(260)	(286)
2020	(70)	40	207	(216)

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së maturimit. Rritja / rënia nuk është simetrike, sepse asetet e kursimit kanë normat 0.25% dhe në rast të rritjes për 100pb ato arrijnë 1.25%, ndërsa në rast rënieje për 100bp, ato arrijnë deri në 0%. E njëjta gjë është me vendosjet; norma e tyre është 0% dhe në rast të rritjes me 100bp arrijnë në 1.00%, dhe në rast rënie ato arrijnë në 0%. Këto asete janë afatshkurtra, prandaj ato kanë prekur vetëm pjesën deri në një vit. Nuk ka asete afatgjata, kështu që ato nuk ndikojnë në pjesën mbi një vit.

31 dhjetor 2021	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Asetet								
Paraja e gatshme dhe në banka	-	-	-	-	-	-	29,081	29,081
Gjendja me BQK	78,542	-	-	-	-	-	-	78,542
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	5,000	-	-	5,000
Kredi klientëve – Norma fikse	5,833	12,014	16,531	30,266	145,755	118,897	-	329,296
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	745	745
Gjithsej	84,375	12,014	16,531	30,266	150,755	118,897	29,826	442,664
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	40,868	7,588	7,246	31,374	101,133	178	222,719	411,106
Detyrimet ndaj bankave	1,086	-	-	-	-	-	-	1,086
Detyrimet tjera	-	-	-	4	1,118	337	985	2,444
Gjithsej	41,954	7,588	7,246	31,378	102,251	515	223,704	414,636
Hendeku	42,421	4,426	9,285	(1,112)	48,504	118,382	(193,878)	28,028
Hendeku kumulativ	42,421	46,847	56,132	55,020	103,524	221,906	28,028	-

26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(c) Rreziku i tregut (vazhdim)
Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2020	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Asetet								
Paraja e gatshme dhe në banka	-	-	-	-	-	-	24,860	24,860
Gjendja me BQK	57,530	-	-	-	-	-	-	57,530
Investimet në letra me vlerë	-	1,519	-	553	23,294	-	-	25,365
Kredi klientëve – Norma fikse	5,149	6,296	11,017	24,132	118,232	82,296	-	247,123
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	916	916
Gjithsej	62,679	7,815	11,017	24,685	141,526	82,296	25,776	355,795
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	35,821	8,082	9,222	60,291	60,642	639	155,585	330,281
Detyrimet ndaj bankave	2,080	-	-	-	-	-	-	2,080
Detyrimet tjera	-	-	-	-	845	1,109	139	2,094
Gjithsej	37,901	8,082	9,222	60,291	61,487	1,748	155,724	334,455
Hendeku	24,778	(267)	1,795	(35,606)	80,039	80,547	(129,947)	21,340
Hendeku kumulativ	24,778	24,511	26,306	(9,299)	70,740	151,287	21,340	-

Rreziku i valutës

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Banka sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë monedha të huaja me kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra. Rreziku i monedhës së huaj nuk është i rëndësishëm, meqë pjesa më e madhe e transakcionve të Bankës janë në monedhën vendase. Monedhat e huaja me të cilat Banka operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si në vijim:

	2021	2020
Valuta	Euro	Euro
1 USD	1.1326	1.2271
1 CHF	1.0331	1.0802
1 GBP	0.8403	0.8990

26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në kursin e këmbimit është si në vijim:

	USD		CHF		GBP	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Ndjeshmëria ndaj kursit	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitim ose Humbje						
+5% e Euros	(204.56)	0.93	(61.03)	14.16	0.11	0.11
- 5% e Euros	204.56	(0.93)	61.03	(14.16)	(0.11)	(0.11)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave të huaj, i shprehur në ekuivalentë të Euro-s është si në vijim:

31 dhjetor 2021	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Asetet					
Paraja e gatshme dhe në banka	20,656	3,934	3,897	594	29,081
Gjendja me BQK	78,542	-	-	-	78,542
Investimet në letra me vlerë	5,000	-	-	-	5,000
Kredi klientëve	329,296	-	-	-	329,296
Asetet tjera	745	-	-	-	745
	434,239	3,934	3,897	594	442,664
Detyrimet					
Detyrime ndaj klientëve	397,372	8,025	5,117	592	411,106
Detyrime ndaj bankës	1,086	-	-	-	1,086
Detyrime tjera	2,444	-	-	-	2,444
	400,902	8,025	5,117	592	414,636
Pozicioni neto në valutë të huaj	33,337	(4,091)	(1,220)	2	28,028
31 dhjetor 2020	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Asetet					
Paraja e gatshme dhe në banka	16,368	3,182	4,869	441	24,860
Gjendja me BQK	57,530	-	-	-	57,530
Investimet në letra me vlerë	25,365	-	-	-	25,365
Kredi klientëve	247,123	-	-	-	247,123
Asetet tjera	916	-	-	-	916
	347,302	3,182	4,869	441	355,795

Detyrimet					
Detyrime ndaj klientëve	322,092	3,164	4,586	439	330,281
Detyrime ndaj bankës	2,080	-	-	-	2,080
Borxhi i varur	-	-	-	-	-
Detyrime tjera	2,094	-	-	-	2,094
	326,266	3,164	4,586	439	334,455
Pozicioni neto në valutë të huaj	21,036	19	283	2	21,340

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është se Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundur, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Bankës.

Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mblihen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar.

Banka ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Bankës dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 arritën në 27,965 mijë euro (me 31 dhjetor 2020: 22,720 mijë euro).

Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Banka përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Për më tepër Banka mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara të detyrimeve financiare të Bankës në bazë të maturiteti kontraktual më të hershëm të mundshëm. Banka pret që flukset monetare të këtyre instrumenteve të ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme nga analiza. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes.

26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**

31 dhjetor 2021	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	29,081	-	-	-	-	-	29,081
Gjendja me BQK	78,542	-	-	-	-	-	78,542
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	5,000	-	5,000
Kredi klientëve	5,833	12,014	16,531	30,266	145,755	118,897	329,296
Pasuri të tjera	745	-	-	-	-	-	745
Gjithsej	114,201	12,014	16,531	30,266	150,755	118,897	442,664
Detyrimet							
Depozita të klientëve	263,587	7,588	7,246	31,374	101,133	178	411,106
Depozita të bankave	1,086	-	-	-	-	-	1,086
Detyrime të tjera	444	181	389	20	1,159	251	2,444
Gjithsej	265,117	7,769	7,635	31,394	102,292	429	414,636
Hendeku	(150,916)	4,245	8,896	(1,128)	48,463	118,468	28,028
Hendeku kumulativ	(150,916)	(146,671)	(137,775)	(138,903)	(90,440)	28,028	-

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2020	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Gjithseji
Asetet							
Paraja e gatshme dhe në banka	24,860	-	-	-	-	-	24,860
Gjendja me BQK	57,530	-	-	-	-	-	57,530
Investimet në letra me vlerë	-	1,519	-	553	23,294	-	25,365
Kredi klientëve	5,150	6,296	11,017	24,132	118,232	82,296	247,123
Asete tjera	916	-	-	-	-	-	916
Gjithsej	88,456	7,815	11,017	24,685	141,526	82,296	355,795
Detyrimet							
Detyrimet ndaj klientëve	191,406	8,082	9,222	60,291	60,642	639	330,281
Detyrimet ndaj bankave	2,080						2,080
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	135	1	17	15	888	1,037	2,094
Gjithsej	193,621	8,083	9,239	60,306	61,530	1,676	334,455
Hendeku likuidues	(105,165)	(268)	1,778	(35,621)	79,996	80,620	21,340
Hendeku kumulativ	(105,165)	(105,433)	(103,655)	(139,276)	(59,280)	21,340	-

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vet për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 9% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për Gjithsejin e fondeve të veta.

Asetet e peshuara me rrezikun

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke iu caktuar një peshë rreziku në përputhje me shumën e vlerësuar të kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i mbështetur ato. Zbatohen gjashtë kategori të peshimit të rrezikut: (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, dhe 150%): për shembull instrumentet e tregut të parasë peshohen me rrezik 0%, i cili nënkupton që nuk nevojitet kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre pasurive. Pasuritë afatgjata materiale peshohen me rrezik 100% çka nënkupton që ato duhet të mbështetet nga Kapitali (Niveli 1) i barabartë me 9% të 2021 të vlerës kontabël. Angazhimet jashtë bilancit të lidhura me kreditimin merren në konsideratë. Shumat më pas peshohen me rrezikun duke përdorur përqindje të njëjta me atë të pasurive të bilancit.

	2021	2020
Pasuritë gjithsej të peshuara me rrezik	294,701	219,890
Pasuritë gjithsej të peshuara me rrezik për rrezikun operacional	21,254	19,788
Gjithsej	315,955	239,678
Kapitali rregullator (gjithsej i kapitalit)	42,842	31,219
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (Gjithsej i kapitalit)	13.56%	13.03%

Rregullorja e BQK-së për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit bankar ka hyrë në fuqi më 01.01.2020 dhe për këtë arsye ka pasur një ndryshim të aktiveve financiare me AMR 100% ku disa prej këtyre aktiveve janë llogaritur me 75% AMR.

Leva financiare

Komiteti i manaxhimit të rrezikut të Bankës rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsiderat koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 3%. Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2021	2020
Gjithsej Pasuritë	460,784	367,882
Ekuiteti	45,189	33,332
Raporti i levës	9.81%	9.06%

26. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

